



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Pukë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

**MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË
NË
BASHKINË PUKË**

Tiranë, 2024

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-11
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-7
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	8-10
II.	HYRJA	10-15
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	15-95
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	15-17
III.2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	17-95
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	17-26
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	26-27
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit për vitin 2022	27-50
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2022	50-63
III.2.4	Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.	63-91
III.2.5	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit	91
III.2.6	Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV)	91-92
III.2.7	Të tjera të dala gjatë auditimit.	92-95
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	95-107
V.	ANEKSE	108-127

SHKURTIME

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AK	Autoritet Kontraktor
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NJP	Njësia e Prokurimit
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditu i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet për një qeverisje të mirë, në përmbushje të objektivave të institucionit të Bashkisë Pukë dhe ligjit nr. 139/15 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt-rakordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga baza e të dhënave të thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230-231 “investime”, u audituan prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Pukë nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022, etj.

Për gjetjet e konstatuara janë mbajtur 9 Akte Konstatimi dhe 1 Akt Verifikimi, të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit të audituar brenda afatit të përfundimit të auditimit.

I.2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Nr. faqe	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 3 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.	63-91	I Lartë	Njësia e Prokurimit Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.
2	Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 2 raste, OE është shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit.	63-91	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Pukë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.
3	Në datën 31.12.2022, gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” është në vlerën 25,959,120 lekë. Në këtë llogari janë pasqyruar të gjitha detyrimet që kanë rrjedhur nga mos ekzekutimet e vendimeve gjyqësore, dhe pjesën më të konsiderueshme të saj e zë vlera e detyrimit prej 22,650,099 lekë që Bashkia ka ndaj shoqërisë “U N”. Ky detyrim është krijuar që në vitin 2018, pasi ndërmjet shoqërisë “U N” dhe Bashkisë Pukë është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr.1421/13, datë 07.10.2016 dhe kontrata shtesë me nr.1421/18, datë 18.10.2017 për “Rigjenerimin e Shëtitores Qendrore Pukë”. Shtesa e kontratës është në vlerë 22,994,496 lekë, financimi do të bëhet nga fondet e Bashkisë Pukë, brenda vitit 2018. Në	50-63	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Pukë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës për të analizuar dhe verifikuar vlerësimin e rezultateve të kësaj analize si dhe të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe për vështirësinë financiare që i është shkaktuar Bashkisë Pukë në vlerë 1,655,604 lekë.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Nr. faqe	Rëndësia	Rekomandimi
	përfundim të punimeve në zbatim të kontratës shtesë, shoqëria “U N” ka lëshuar faturën tatimore nr. 7 datë 25.03.2018 në vlerën e plotë të saj, prej 22,994,496 lekë. Bashkia nuk ka bërë likuidimin e kësaj fature në shkëlqje të kushteve të kontratës shtesë dhe shoqëria “U N” i është drejtuar gjykatave për lëshimin e urdhër ekzekutimit për titullin ekzekutiv të faturës tatimore. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr.58, datë 08.06.2022, ka Vendosur që Bashkia Pukë ti paguaj shoqërisë “U N” faturën tatimore në vlerën e plotë të saj prej 22,994,496 lekë. Për mungesë fondesh, Bashkia nuk ka bërë ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe të tarifës përmbartimore dhe për këtë arsye, me urdhër të zyrës përmbartimore nr.477, datë 02.09.2022 Dega e Thesarit Pukë ka vendosur në sekuestro konservative llogarinë “602” të Bashkisë për ekzekutimin e vlerës 24,650,099 lekë. Vlera e detyrimit prej 24,650,099 lekë përbëhet, nga detyrimi i pa likuiduar sipas faturës tatimore në shumën 22,994,495 lekë dhe nga tarifa e shërbimit përmbartimor në shumën 1,655,604 lekë. Nga mos pagesa e këtij detyrimi në kundërshtim me kushtet e kontratës shtesë dhe të nenit 16, të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, janë rritur padrejtësisht kostot buxhetore për Bashkinë Pukë në vlerën 1,655,604 lekë.			
4	Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Pukë në vlerën gjithsej 26,854,446 lekë, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithsej 107 subjekte në vlerën 24,108,029 lekë, dhe debitorë nga toka bujqësore në vlerën 2,746,417 lekë. -Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt-konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit. -Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.	27-50	I Lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për 107 subjekte në vlerën 26,854,446 lekë dhe debitorë nga toka bujqësore në vlerën 2,746,417 lekë.
5	Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Tatim Taksave për planifikimin të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”, nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Pukë dhe NJA, për vitin 2022 janë taksuar 3.310 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. -Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Pukë dhe NJA janë 5.320 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 3.310 familje me një diferencë me 2010 familje të pataksuara. -Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Pukë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe sipas NJA për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim për NJA Pukë 2.000 lekë * 863 familje mesatarisht taksuar më pak =	27-50	I Lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të, për 2,010 familje të pa taksuara në vlerën 2,528,900 lekë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Pukë, të marrë masat e nevojshme për krijimin e një regjistri mbi taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar”, duke pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme dhe evidentimin real të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë.

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Nr. faqe	Rëndësia	Rekomandimi
	1,726,000 lekë planifikuar më pak, për NJA Gjergjan 700 lekë * 629 familje mesatarisht taksuar më pak = 440,300 lekë planifikuar më pak si dhe për NJA Qerret 700 lekë * 518 familje mesatarisht taksuar më pak = 362,600 lekë planifikuar më pak me vlerë totale 2,528,900 lekë . -Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”.			
6	Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Pukë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 411 mijë lekë, për 2 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë.	27-50	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Pukë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
7	Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 87%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.	27-50	I Lartë	Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurt për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.
8	Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, u konstatua se janë 104 fatura të pa likuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën për vlerën totale 38,492,096 lekë. -Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim në 30 raste.	27-50	I Lartë	Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.
9	Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2022 paraqitet në me saldo debitore në vlerën 49,517,165 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 ka qenë në vlerën 43,436,069 lekë, me një shtesë në vlerën 6,081,096 lekë.	50-63	I Lartë	Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Zyrën e Taksave vendore, Bashkia Pukë të marrë masa për evidentimin

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Nr. faqe	Rëndësia	Rekomandimi
	Kjo vlerë e shtuar ka të bëjë me zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH për regjistrimin e detyrimeve në kontabilitet të të ardhurave të planifikuara të pa mbledhura nga taksat familjare (taksa e pronës, taksës, pastrimit), tarifa e lëshimit të autorizimeve për veprimtaritë e shitjes së karburanteve, etj. Gjatë vitit 2022 këto taksa e tarifa janë arkëtuar vetëm për 1,381,307 lekë dhe për detyrimin e mbetur të pa arkëtuar në vlerën 49,517,165 lekë, Bashkia Pukë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e këtyre debitorëve.			dhe kontabilizim të detyrimeve për taksat/tarifa vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë në llog 468 “Debitorë të ndryshëm”, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tyre.
10	Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 38,492,096 lekë . Nga analiza, rezultoi se kjo llogari gjate këtij viti është pakësuar për vlerën 8,926,516 lekë. Një pjesë e konsiderueshme e këto detyrimet të prapambetura të pashlyera janë të trashëguara nga periudha para reformës territoriale administrative vendore të vitit 2016. Vlera e detyrimeve të pashlyera është relativisht e konsiderueshme për buxhetin e kësaj Bashkie, cila nuk është e angazhuar maksimalisht për t’i planifikuar dhe likuiduar ato pjesë -pjesë deri në shuarjen e plotë të tyre.	50-63	I Lartë	Bashkia Pukë, për çdo vit, gjatë planifikimeve buxhetore të parashikoj në buxhetet vjetore fonde për shlyerjen pjesore të detyrimeve të prapambetura, deri në shuarjen e plotë të tyre.

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi Pasqyrat Financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200¹, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar me rezervë për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Pukë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin me rezervë”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare Bashkisë Pukë më 31 dhjetor 2022, referuar Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Pukë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme² për të dhënë një bazë për opinionin tonë³.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

1. Nga krahasimi i Pasqyrave Financiare të Bashkisë, me Pasqyrat Financiare të sistemit të Thesarit, konstatohet se pasqyrat financiare të sistemin e thesarit nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë, konkretisht: në totalin e Aktivit, konstatohet një diferencë prej 111,559,140 lekë më shumë në PF të Bashkisë, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra konstatohet, diferencë prej 302,553,291 lekë më shumë në PF të Bashkisë dhe llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, ka vlerën 59,178,543 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0 (zero).

2. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet me saldo debitore në vlerën 49,517,165 lekë. Gjatë këtij viti, taksat e tarifa janë arkëtuar vetëm për 1,381,307 lekë dhe për detyrimin e mbetur të pa arkëtuar, Bashkia është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e këtyre debitorëve.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

² SNA 500

³ SNA 700

3. Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, paraqitet në vlerën 38,492,096 lekë. Vlera e detyrimeve të pashlyera është relativisht e konsiderueshme për buxhetin e kësaj Bashkie, cila nuk është e angazhuar maksimalisht për ti planifikuar dhe likuiduar ato pjesë-pjesë deri në shuarjen e plotë të tyre.

4. Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Pukë përbëhet nga 5 studime e projekte në vlerën 1,137,600 lekë. Deri në fund të vitit 2022, asnjë nga këto projekte nuk është financuar dhe nuk është realizuar.

5. Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione”, paraqitet në vlerën 653,691,341 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, paraqitet në vlerën 584,684,266 lekë. Në disa objekte ekzistuese janë kryer punime të ndryshme dhe vlera e këtyre punimeve nuk i është shtuar vlerës totale të objektit. Këto punime janë regjistruar në llogarinë analitike vetëm për vlerën e investimit të kryer pa emërtuar saktësisht objektin në të cilin është kryer punimi.

6. Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” është në vlerën 13,842,857 lekë. Për disa objekte të përfunduara, Bashkia nuk ka ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të tyre, duke bllokuar kthimin e garancisë së punimeve ndaj sipërmarrësve të punimeve.

7. Në inventarët e Bashkisë, ndodhen materiale të dëmtuara, amortizuara dhe jashtë përdorimi me vlerën totale 13,643,806 lekë dhe për to, Bashkia nuk ka vazhduar procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit.

8. Llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” është në vlerën 25,959,120 lekë, që përfaqëson detyrimet që kanë rrjedhur nga mos ekzekutimet e vendimeve gjyqësore, dhe pjesën kryesore e zë detyrimi prej 24,650,099 lekë që, Bashkia ka ndaj shoqërisë “U N”. Vlera e detyrimit përbëhet, nga detyrimi i pa likuiduar në shumën 22,994,495 lekë dhe nga tarifa e shërbimit përmbarimor në shumën 1,655,604 lekë. Nga mos pagesa e këtij detyrimi në kundërshtim me kushtet e kontratës janë rritur padrejtësisht kostot buxhetore në vlerën 1,655,604 lekë.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Pukë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për Opinionin:

Opinionin e dhënë mbi përputhshmërinë e mbështesim në konstatimet e mëposhtme:

Në auditimin e veprimtarisë së subjektit Bashkia Pukë për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriteret të plotësuar, si dhe planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, si më poshtë vijon:

-Në 3 procedura prokurimi të audituara me fond limit 8,294 mijë lekë, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të PP.

-Në 2 procedura prokurimi të audituara me fond limit 4,116 mijë lekë, OE i kualifikuar nuk plotëson kriteret e vendosura.

- Moszbatimin plotësisht të kuadrit rregullator të fushës për arkëtimin e të drejtave të konstatuara (taksa, tarifa dhe qira) ndaj palëve të treta, në vlerën 26,854 mijë lekë.

Sa më sipër, shkeljet dhe mangësitë e evidentuara përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura që justifikojnë dhënien e opinionit të modifikuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pukë:

Drejtimi i bashkisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 08, datë

09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj, kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që në të përmbluar të kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit⁴.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 867/1 datë 10.10.2023 Prot., i ndryshuar, me shkresën nr. 867/2 prot., datë 02.11.2023, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin “Bashkia Pukë” nga data 13.10.2023 deri në datën 20.11.2023, u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë”, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, auditim financiar dhe përputhshmërie nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. G, Përgjegjës Grupi;
2. A. B, Anëtarë.
3. B. A, Anëtarë.

II.1. Objekti i Auditimit

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

⁴ Objekti i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

II.2. Qëllimi i auditimit

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve. Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3. Identifikimi i çështjes

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pukë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Niveli drejtues i Bashkisë Pukë (Kryetari i bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Pukë, Drejtorët e drejtorive dhe Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Pukë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinionin i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë

konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Pukë, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

II.6. Kriteret e vlerësimit

Lloji i dokumentit:

Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore.

Standardet e auditimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj;
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;

Ligje:

Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH me ndryshime;
Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;
Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;
Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
Ligji nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

VKM:

VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;
VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar;
VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar;
VKM nr.736, datë 1.7.2009 për disa ndryshime në VKM nr.808, datë 4.12.2003 të këshillit të ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”;
VKM nr. 165, datë 2.3.2016 “Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

Udhëzime:

Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat

Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar;
 Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
 Udhëzimi i MFE nr. 30, datë 27.12.2012 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
 Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
 Udhëzimi i MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJVQ-ve”;
 Udhëzimi i MFE nr.10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, etj;
 Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”;
 Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”;
 Rregullore mbi organizimin e funksionimit të Bashkisë, etj.

Rregullore:

II.7. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”;
- ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”;
- INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*”;
- ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”;
- INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

II.8. Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë

dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe
- Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin:

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

▪ **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

▪ **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ **Intervista**

▪ **Raporte dhe Informacione**

▪ **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

II.9. Dokumentimi i auditimit

Mbi bazën e Pyetësorëve dhe Testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartuan Akt-Konstatimet dhe Akt-Verifikimet, si dhe pas shqyrtimit të komenteve dhe

shpjegimeve të subjektit të audituar, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili është materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Opinionit të Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre;
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth qendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi Bashkinë Pukë.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni qjeografik

Zona Gjeografike: Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 16,836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53

km² me një densitet prej 33.3 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 21.89 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Kukës e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare. Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët.⁵

Forma dhe mënyra e organizimit:

Struktura organizative aktuale është miratuar me VKB nr. 48, nr. 2356/2 prot., datë 05.01.2022, miratuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 30/2, datë 19.01.2022 dhe ka në përbërje të saj 318 punonjës duke përfshirë dhe funksionet e deleguara.

Njësitë Administrative (ish-komunat) dhe fshatrat

Emri i Njësive	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Pukë	Qyteti: Pukë, Fshatrat: Pukë, Lajthizë
Gjegjan	Fshatrat: Dom, Gjegjan, Gojan i Vogël, Rras, Kuzhnen, Gojan i Madh, Shkozë, Kimëz, Kalivare, Mesul
Rrapë	Fshatrat: Breg, Rrapë, Kabash, Buhot, Bicaj, Blinisht, Lumzi, Meçe
Qelëz	Fshatrat: Qelëz, Bushat, Dushnezë, Midhë, Buzhalë, Dedaj, Levrushk, Ukth, Qerret i Vogël
Qerret	Fshatrat: Qerret, Luf, Dush, Karmë, Kçirë, Luf-Plan, Korthpulë, Kaftall, Tejkodër, Gomsiqe, Vrith, Plet.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektivit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Pukë:

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

Funksionet kryesore të Bashkisë Pukë kryhen në fushën e:

- Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
- Shërbimeve sociale.
- Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
- Mbrojtjes së mjedisit.
- Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
- Zhvillimit ekonomik vendor.
- Sigurisë publike.

Financat.

⁵ Burimi: <https://portavendore.al/bashkia-puke/pasaporta-e-bashkise-puke/>

Bashkia Pukë ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

- a) krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
- b) vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
- ç) mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

III.2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Në drejtim të vlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Pukë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimin e objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i Kontrollit”, “Menaxhimi i Riskut”, “Aktivitetet e Kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

1.Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Për vitin 2022 është vepruar në bazë të Rregullores së Brendshme miratuar me Vendimin nr. 247, datë 30.12.2015, pasi nuk ka Rregullore të Brendshme të përditësuar.

Nuk ka Kod Etike të miratuar, por rregullat mbi etikën përshkruhen në nenin 20 në rregulloren e brendshme.

Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi.

Nuk ka gjurmë për njohjen e stafit me rregulloren e brendshme, komunikimi mbi rregulloren e brendshme është kryer verbalisht.

Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë edhe në Rregulloren e Brendshme. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrdhënieve me Publikun) dhe zyrën me një ndalesë, duke i'u adresuar strukturave të bashkisë sipas problemeve, të cilat të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet firmosen nga drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo procedurë nuk është

përcaktuar në Rregulloren e Brendshme.

Nuk ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj, gjithashtu nuk ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Nga drejtuesi i institucionit, duhet të sigurohet mbikëqyrja e monitorimi i punës për secilin punonjës, në mënyrë që të sigurohet si duhet integriteti personal dhe etika profesionale, duke përjashtuar konfliktin e interesit në kryerjen e detyrave funksionale, në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, në lidhje me “ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, dhe kontrollin”.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

Për vitin 2022 ka plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët nuk janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës, gjithashtu nuk ka raporte vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në kreun II “Organizimi i Administratës së Bashkisë” dhe Kreut III “Funksionimi i Administratës së Bashkisë” neni 16 të Rregullores së Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi periodik i realizimit të planeve nga Drejtorët e Përgjithshëm në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar zëvendës/kryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësive publike, për vitin 2022 ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere, bashkia merr raporte në lidhje me vendimmarrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga projekti i bashkive të forta. Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendimmarrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Pukë me Vendimin e Kryetarit nr.247, datë 30.12.2015 “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Pukë dhe Njësive Administrative, konstatohet se rregullorja e brendshme është që nga viti 2015 dhe diktohet nevoja urgjente e rishikimit të kësaj rregulloreje, Konstatohet se përgjegjësi dhe specialisti i burimeve njerëzore kanë mbivendosje të detyrave, si psh hartimin e programeve të trajnimit/planin e rekrutimit, në raste të caktuara parashikohet kryerja e detyrave të tjera që ngarkohen nga drejtuesi/përgjegjësi i sektorit, por pa i specifikuar detyrat përkatëse (me qëllim që mos të krijohen hapësira për interpretim/subjektivizëm). Në rregulloren e brendshme nuk përfshihen funksionet: “Administrimi i pyjeve dhe kullotave”, “Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile”, “Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit”, “Rrugët rurale”, “Qendra kulturore e fëmijëve” dhe “Shërbimi mbështetës në arsimin bazë dhe arsimin e mesëm”, funksione këto të transferuara që në vitin 2016.

Specialisti i buxhetit ka mbivendosje detyrash me Përgjegjësin e sektorit të financës, konkretisht në hartimin e kërkesave për shtesë fondesh buxhetore. Për llogaritarin përcaktohet si detyrë “Mban evidencën e plotësimit organik të institucionit dhe në çdo rast që

kërkohet nga eprorët raporton për këtë tregues”, ndërkohë që kjo detyrë duhet të përcaktohet për sektorin e burimeve njerëzore;

Struktura organizative e Bashkisë Pukë është miratuar me VKB nr. 48, datë 19.01.2022, dhe ka në përbërje të saj 318 punonjës duke përfshirë edhe funksionet e deleguara.

Për periudhën objekt auditimi rezultoi se ka pasur pak ndryshime të strukturës, në numrin e saj. Ka pasur një rritje të numrit të punonjësve nga njëri vit në tjetrin.

Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, por është bërë pjesë e dokumentit të PBA-ve, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

Për çdo drejtori janë përcaktuar objektet, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjësi sektori dhe specialist, por nuk janë përcaktuar objektivat për secilin drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Mungon raporti i vlerësimit nga mos ekzistenca e njësisë së auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Bashkia Pukë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rendësishme dhe informacione për njësi vendore, duke përfshirë organigramën, rregulloren, njësitë e varësisë etj.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencave”.

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit.

Nuk janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nëndarjeve dhe fushave përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

- Për Bashkinë Pukë, nëpunës autorizues është kryetari i bashkisë, si dhe zëvendës kryetari (në mungesë të kryetarit).

Kryetari është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i drejtorisë së administrimit të përgjithshëm. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjëshmërinë menaxheriale”.

Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar “Delegimi i kompetencave” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative” si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokoli i institucionit rezultoi se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësisë të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhërin nr.115, datë 21.04.2022 për ngritjen e GMS:

Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:

Bashkia Pukë nuk ka miratuar plan pune vjetorë lidhur me funksionimin e “Grupit për Menaxhimin Strategjik”.

Nuk administrohen procesverbalet e takimit të GMS, për të dokumentuar funksionimin e këtij grupi.

Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

2.Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, konstatohet se nga Bashkia Pukë nuk ka plane operationale mujore , 6 mujore dhe as vjetore të punës, si dhe nuk është hartuar plani i përgjithshëm i zhvillimit strategjik (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Pukë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

- Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në Bashkinë Pukë nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një kordinator të deleguar të riskut. Nuk ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut.

- Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe planet e menaxhimit të riskut nuk janë hartuar. Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë Bashkinë, ku të identifikoheshin dhe të bëhej vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

-Nuk është ngritur një grup menaxhimi i riskut dhe grupi i menxhimit strategjik. Nuk është ndërmarrë dhe dokumentuar asnjë veprim për të adresuar mangësitë dhe përditësimi i regjistrit të riskut.

Nuk është hartuar në nivel Bashkie regjistri i riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK dhe riskut, për rrjedhojë ka sjellë mosidentifikimin dhe vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut, *Këto mosveprime janë në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.*

Nuk ka njësi të Auditit të Brendshëm, nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel apo Word. Në Bashkinë Pukë, edhe Drejtoria e administrimit të përgjithshëm, Sektori i financës, për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes së të dhënave e cila kryhet nga sektori i financës, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Në bazë të këtij programi me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e administrimit të përgjithshëm dhe hartimi i pasqyrave financiare, gjithashtu edhe Sektori i tatim-taksave operon me programin Excel për monitorimin e të ardhurave. Për çdo muaj dhe vit kryhen akt-rakordimet me Degën e Thesarit për të ardhurat dhe shpenzimet.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”. Bashkia Pukë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj nuk ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke mos marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke mos përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Bashkia Pukë nuk ka një sistem të kontrollit të brendshëm.

3.Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar edhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.

Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i drejtorisë së administrimit të përgjithshëm (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i drejtorisë së administrimit të përgjithshëm hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të përlogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimve/shërbimeve.

Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili përditësohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj. dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël. Në Rregulloren e brendshme për dokumentacionin e finances nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, (megjithëse jo me të gjithë komponentët) i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyra dhe kartelat personale të konfirmuara nga përgjegjësit materialë. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur këto aktive nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet. Në përgjithësi për procedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhëri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi, si dhe për asgjësimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, procesverbalet dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe procesverbalet për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet përkatëse kontabël.

Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Pukë, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (Sh.A.U.K Pukë) sipas marrëveshjes së Bashkisë Pukë të bërë me këtë agjent. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë

kontabilizuar. Bashkia Pukë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrollin e angazhimeve, menaxhimin e investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i degës së thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga bashkia.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Pukë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe ka vetëm detyra për administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe instalimin e programeve bazë e profesional në kompjuterat e bashkisë. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, fireëall-et, kufizimin e ndërhyrjeve në të dhënat e IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Pukë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Sipas Strukturës Organike të miratuar Sektori i Informatizimit dhe Teknologjisë së Shërbimit , pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi është vetëm një specialistë dhe nuk mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga mungesa e sektorit të auditit.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë të Drejtorëve dhe Përgjegjësve për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke mos eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Me vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve merret Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, pasi nuk ekzistojnë procedura operative të shkruara për këto procese. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj drejtorive sipas rregullores së Brendshme.

- Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjeve e ditareve, hartime PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtoria. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.

Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”). Nga Auditimi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

4.Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”. Bashkia Pukë disponon faqen e saj zyrtare në web: www.bashkiapuke.gov.al, ku pasqyrohet aktiviteti i saj si Rregullorja e Brendshme, broshura, raporti i performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura

organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut, planifikimin dhe realizimin e prokurimeve, institucionet e varësisë, nuk përditësohet informacioni mbi ndryshimet në strukturën e bashkisë, paketat fiskale, etj, Sistemi i raportimit nuk ofron as duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit nuk janë hartuar çdo 4-muaj dhe të paraqiten pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit. Nuk ka Raportime periodike por vetëm vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit фондеве dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

- Raportet për **detyrimet e konstatuara**, por të papaguara nuk janë hartuar çdo 3 muaj dhe të paraqiten në degën e thesarit dhe MFE.

-**Në lidhje me parimin 14:** “Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm sistemin elektronik dhe shkresor”.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë në mënyrë verbale dhe elektronik, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në Rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenin 16.

“Bashkëpunimi nëpërmjet strukturave të administratës së bashkisë”. Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Pukë punonjësit punojnë me sistemet informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejt me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale ose e-maile.

Grupi auditues konstaton se punonjësit nuk kanë email-e zyrtar të institucionit por vetëm emaillet e tyre personale.

Në faqen zyrtare në internet të Bashkisë Pukë janë të publikuar dokumentet Kryesore, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda vendit dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor e të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Për vitin 2022 nga Bashkia Pukë nuk janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit, pra mungon dokumenti i konsultimit publik.

5.Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion nuk konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili duhet të hartohet cdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar cdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar” dhe “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Pukë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”, me shkresën nr. 2312/2 prot, datë 27.02.2023.

- Në Bashkinë Pukë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH. Gjithashtu nga mos ekzistenca e sektorit të Auditit të brendshëm nuk ka rekomandime për bashkinë Pukë.

- Në Bashkinë Pukë aktivitetet e vlerësimit të njesisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të përfomancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

- Një nga drejtimit e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm. Auditimi i brendshëm në periudhën objekt nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar. Për rrjedhojë nuk ka auditime mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe të jepene vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me kryetarin e bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: Probleme dhe parregullsi në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin në Bashkinë Pukë.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njesisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Mjedisi i Kontrollit: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

Menaxhimi i Riskut: Ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, sipas nenit 21 i Ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i

ndryshuar.

Proçesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në Bashkinë Pukë, Drejtoria e administrimit të përgjithshëm, Sektori i financës dhe Sektori i tatim taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

Regjistri i riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK nuk është i plotë dhe ka sjellë mosidentifikimin dhe mosvlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Pukë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqsish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm një specialistë që mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj.

Informimi dhe Komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Në Bashkinë Pukë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në Bashkinë Pukë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për

zgjidhjet e mundshme.

Përsa më sipër, mbi mangësitë e konstatuara mbajnë përgjegjësi: z. Gj. Gj, ish Kryetar i Bashkisë Pukë, znj. F. P, në funksionin e ish Drejtorit të drejtorisë së administrimit të përgjithshëm, znj. E. P në funksionin e ish Drejtorit të drejtorisë së burimeve njerëzore.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23, 24.

Ndikimi/Efekti: Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mungesa e analizimit të cilësisë së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, mos trajnimi për rritjen profesionale të stafit, ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të institucionit, lënë hapësira për ndodhjen e anomalive dhe mos informimin e titullarit për këto anomali, nuk nxjerrin qartë përgjegjësitë etj.

Shkaku: Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave. Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

III.2.1.1. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm

2.1.1. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Pukë;
2. Planet Strategjike dhe vjetore, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2022;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Nga shqyrtimi i kërkesës për paraqitjen e dokumentacionit të mësipërm, rezultoi se:

Bashkia Pukë në secilën organikë për vitet 2022, nuk ka përcaktuar edhe miratimin strukturës së punës për Njësinë e Auditit të Brendshëm. Sipas informacionit të paraqitur nga personi përgjegjës, kjo ka ardhur si shkak i mungesës së kapaciteteve njerëzore për të kryer këtë detyrë pranë kësaj bashkie. Megjithatë, nuk u paraqit asnjë dokumentacion i cili të provojë se nga ana e Institucionit, të jetë shpallur vend vakant për rekrutimin e punonjësve për pozicionin e punës së audituesit të brendshëm.

Sipas informacionit të dërguar në rrugë elektronike, pas kërkesës së audituesve të KLSH, rezultoi se nga Titullari i Institucionit z. Gj. Gj, nuk është lidhur asnjë marrëveshje me njësi tjera publike të cilat kanë njësi auditit të brendshëm dhe kapacitete të nevojshme për kryerje të auditit të brendshëm, kjo në kundërshtim me nenin 10 pika c të ligjit me nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”, dhe nenin 6 pika a të VKM-së me nr. 83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Mos funksionimi i strukturës së Auditit të Brendshëm, paraqet risk të lartë në raport me funksionin, veprimtarinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Titulli i gjetjes: Mos funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekti: Nga auditimi mbi aktivitetin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Pukë për periudhën objekt auditimi, nga data 01.01.2022 – 31.12.2022, rezulton se:

Megjithëse është krijuar si strukturë Njësia e Auditit të Brendshëm me vendim nr. 48, datë 19.01.2022, ajo nuk ka funksionuar për asnjë ditë pasi nuk është plotësuar me punonjës.

Shkak: Mungesa e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Pukë, në koordinim me Drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëjës nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikën e ngjashme nga bashki të tjera.

III.2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.2.1. Programimi i PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022:

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për vitin 2022 për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.49, datë 30.12.2021, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 54/1 prot., datë 24.01.2023. Në vijë të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- b. Përmirësimi i rrjetit rrugor rural;
- c. Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- d. Ndriçimi i rrugëve;
- e. Përmirësimi i kushteve për turizmin;
- f. Ofrimi i shërbimeve publike;
- g. Riparimi i objekteve arsimore.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme).

Programi i të ardhurave për vitin 2022 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.43, datë 30.12.2021.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Pukë për vitin 2022 është 418,678 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2022, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2022, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1, PBA për periudhën 2022-2024 sipas programeve ekonomike që menaxhon
Bashkia Pukë, 000/lekë

Nr.	Kodi	Programi	Fakti i vitit paraardhës viti 2021	PBA Plan viti 2022	Buxheti vjetor 2022 Plani i Rishikuar	Realizimi i periudhës progresiv	Diferenca 5=(4-3)
1	01110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	57,985	61,971	59,605	56,775	-2,830
2	03140	Shërbimet e Policisë Vendore	1,909	2,598	2,678	2,585	-93
3	03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	15,578	25,675	23,946	14,879	-9,067
4	04130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,195	1,570	1,610	1,591	-19
5	04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,353	15,457	15,456	11,506	-3,950
6	04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	868	6,574	6,474	2,126	-4,348
7	04520	Rrjeti rrugor rural	9,063	11,788	13,143	12,264	-879
8	05100	Menaxhimi i mbetjeve	7,592	11,674	13,894	11,557	-2,337
9	06260	Shërbime publike vendore	60,616	55,626	58,779	45,287	-13,492
10	08130	Sport dhe argëtim	21,626	15,805	24,177	24,074	-103
11	08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	4,821	5,223	5,422	4,965	-457
12	09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	44,871	52,052	52,797	44,557	-8,240
13	09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	20,450	28,678	28,478	20,643	-7,835
14	10661	Strehimi social	4,646	4,710	4,870	1,982	-2,888
15	10430	Përkujdesi Social	117,875	63,990	121,603	120,306	-1,297
16	06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	126,246	0	32,823	32,367	-456
17	01170	Gjendja civile	2,342	2,380	2,486	2,440	-46
18	01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	7,489	6,275	8,455	6,132	-2,323
19	06440	Ndriçim rrugësh	3,680	3,000	3,000	2,642	-358
20	01620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	1,122	0	0	0	0
21	06210	Programet e zhvillimit	1,948	0	0	0	0
22	04980	Fondi i emergjencave dhe rezervave	0	2,000	1,823	0	-1,823
Totali i shpenzimeve të njësisë			523,275	377,046	481,519	418,678	-62,841

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2022-2024, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 62,841 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Shërbimet Publike Vendore”, “Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile”, “Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor” dhe “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2022-2024 Bashkia Pukë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2, Planifikimi i të ardhurave, në 000/lekë

Përshkrimi	Planifikimi 2022
Te ardhura tatimore	52,911
Te ardhura jotatimore	873
TOTAL	53,784

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Mangësi në zbatimin e procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

Situata: Për PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon: *“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”*.

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Pukë, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

Kriteri: Shkronja “ç” në nenin 5, pika 3 në nenin 13, pika 1 në nenin 33, pika 1 në nenin 35, pika 1 në nenin 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 3 në nenin 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Pukë.

Rëndësia: I Mesëm.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore

nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Pukë.

-Të dokumentohet procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Të pasqyrohet trajtimi i risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

Rekomandimi: Për çdo vit buxhetor të kryhen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pukë.

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të celura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtë artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Pukë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Pukë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Pukë, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3, Planifikimi i buxhetit për vitin 2022, Bashkia Pukë, në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2022	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	4,613	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	35,606	
3	Trashëguar nga transfera specifike	108,314	
4	Të trashëguara nga FZHR		
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	53,781	
6	Granti	112,704	
7	Transferta specifike	100,675	
8	Transferta e kushtëzuar	143,439	
9	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		198,560
10	Shpenzime operative (602)		61,040
11	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		
12	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		2,000
13	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit		74,473
14	Shpenzime (603+604+606)		124,730
Totali i buxhetit		460,803	460,803

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësitë e Varësisë) për vitin 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **460,803 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2022, kanë ndodhur 8 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4, Ndryshimet buxhetore për vitin 2022, 000/lekë

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë vitit			Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve				
	Nr. datë	Vlera	Urdhër/Nr. Datë	VKB / Nr. Datë	Vlera	Shtuar artikulli / Pakësuar artikulli				
						Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma	
Viti 2022	49_30/12/2021	460,803		12_31.03.2022	3,372	231	1,900			
						602	600			
						602	872			
			28_30.06.2022	0	604	2,500	600 602	500 2,000		
			233_25.08.2022		2,458		231	1,951		
							602	507		
				41_06.10.2022	0	604	2,650			
						600	200	600	2,850	
				51_14.11.2022	0	604	3,153	231	3,153	
				52_14.11.2022	0	602	1,000	604	1,000	
			346_16.12.2022		0	231	2,000			
						602	4,573			
						604	719	604	7,293	
			360_30.12.2022		0			600	2,205	
					601	20				
					602	2,030				
					604	59				
Totali Viti 2022		460,803			5,830		27,845		22,016	

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5, Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Programi	Plan Progresiv 2022	Fakti	%
1	1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	59,605,091	56,774,166	95
2	3140	Shërbimet e Policisë Vendore	2,678,000	2,583,922	96
3	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	23,946,000	14,878,843	62

4	4130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	1,610,000	1,590,265	99
5	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	15,457,000	11,505,901	74
6	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	6,474,000	2,125,294	33
7	4520	Rrjeti rrugor rural	13,143,251	12,262,791	93
8	5100	Menaxhimi i mbetjeve	13,894,225	11,555,045	83
9	6260	Shërbime publike vendore	58,778,000	45,286,151	77
10	8130	Sport dhe argëtim	24,177,451	2,407,9461	100
11	8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	5,422,000	4,964,992	92
12	9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	52,796,812	44,556,271	84
13	9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	28,478,000	20,641,710	72
14	10140	Cerdhe ditore	7,516,000	6,896,044	92
15	10661	Strehimi social	4,870,000	1,981,710	41
16	10430	Përkujdesi Social	114,087,000	113,413,482	99
17	6370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	32,823,211	32,366,870	99
18	1170	Gjendja civile	2,486,000	2,439,711	98
19	1710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	8,454,658	6,131,983	73
20	6440	Ndriçim rrugësh	3,000,000	2,643,668	88
21	1620	Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale	0	0	0
22	6210	Programet e zhvillimit			0
23	4980	Fondi i emergjencave dhe rezervave	1,823,000	0	
Totali i Shpenzimeve të Njësisë			481,519,699	418,678,280	87%

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

Për vitin 2022 realizimi i buxhetit është në nivelin 87%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Sport dhe argëtim”, “Përkujdesi social”, “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, “Gjendja Civile”, dhe “Planifikim Menaxhimi dhe Administrimi;

Programi me realizimin më të ulët është “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit”;

2.2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Pukë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Pukë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.


Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2024, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6, Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022, 000/lekë

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	165,533	155,600	94
601	Sigurime Shoqërore	27,111	25,896	96
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	64,487	41,707	65
604	Transferta Korente të Brendshme	21,163	21,063	100
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	120,202	119,219	99
609	Fondi reserve	3,232	0	0
230	Kapitaletë Patrupëzuara	0	0	0
231	Kapitaletë Trupëzuara	79,791	55,192	69.2
TOTAL		481,520	418,678	87%

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Pesha e secilit artikull ndaj totalit



Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 87%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 “Tranferta Korente të Brendshmë”, “Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ” duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, kapitale të trupëzuara si dhe realizimin më të ulët e kanë mallra dhe shërbime të tjera. Vihet re se për vitin 2022 art. (602) mallra dhe shërbime të tjera paraqiten 65 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.

Tabela nr.7, Buxheti sipas burimeve të financimit 2022, 000/lekë

Art.	Emertimi	Fakt 2022				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
		Gjithesëj	Të ardhurat e veta	Tr.Pakushtëzuar	Tr.kushtëz Specifike	
600	Paga	155,600	13,466	65,044	77,089	9
601	Sigurime Shoqërore	25,896	2,130	10,736	13,031	8
602	Shp. Operative	41,707	6,324	23,476	11,907	15
604	Transf. Korrente të Brendshme	21,063	8,516	12,547	0	40
606	Transf. për familje dhe individ	119,219	0	3,052	116,167	0
231	Investime	55,192	7,044	11,176	36,972	13
Total		418,677	37,480	126,031	255,166	9%

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar specifike, në vlerën 255,166 mijë lekë ose 60 % të fondeve të shpenzuara për vitin 2022, për të vijuar me transfertën e pakushtëzuar në vlerën 126,031 mijë lekë ose 30% të fondeve sipas burimit të financimit dhe të ardhurat e veta në vlerën 37,480 mijë lekë ose 9% të fondeve sipas burimit të financimit.

Transferta e kushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar specifike për vitin 2022 është realizuar në vlerën 255,166 mijë lekë, ose 60 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar specifike, e zënë shpenzimet për Transferta për familje dhe individ dhe paga dhe sigurime shoqërore.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 126,031 mijë lekë, ose 30% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga, shpenzime operative dhe Investime.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 37,480 mijë lekë, ose 9 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, transfera korrente të brendshme dhe investime.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Me miratimin e buxhetit për vitin 2022 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2022 është planifikuar në masën 6,275 mijë lekë. Sipas të dhënave nga Bashkia Pukë nga fondi rezerve/dhe kontigjencës nuk janë përdorur gjatë vitit.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Pukë.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Pukë përgjatë periudhës 2022 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

➤ Realizimi i Investimeve.

Titulli gjetjes: Mangësi në planifikimin e procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 87 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Pika 24 dhe 25 në nenin 3, neni 47 në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

➤ Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 muajor në Këshillin Bashkiak.

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44⁶, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konstatohet se për vitin 2022 nuk administrohet

⁶ Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

raporti i 4 mujorit të dytë për monitorimin e zbatimit të buxhetit, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

Për vitin 2022, Bashkia Pukë me shkresën nr. 1107 prot., datë 31.05.2022 ka përcjellë në MFE raportin e monitorimit të buxhetit për 4 mujorin e parë të vitit 2022, si dhe me shkresën nr. 503 prot., datë 28.02.2023 ka përcjellë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Nuk administrohet Raporti i 4 mujorit të dytë.

2.3.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Pukë, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE.

Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2022.

Tabela nr.8, Detyrimet e prapambetura për periudhën 2022, 000/lekë

Detyrime e NJQV 2022	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2022	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2022	Mbetja në fund të vitit 31.12.2022
a	1	2	3=(1+2)	4	5=(3-4)
Investime	10,954,601	27,153,265	38,107,866	31,153,265	6,954,601
Investime nga FZSH					
Mallra dhe shërbime	5,692,577	32,400	5,724,977	32,400	5,692,577
Vendime gjyqësore	30,771,434	2,105,604	32,877,038	7,032,120	25,844,918
Të tjera					
Totali	47,418,612	29,291,269	76,709,881	38,217,785	38,492,096
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2022					57,557,514

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Pukë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr. 201/1 prot., datë 08.02.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Pukë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën **38,492 mijë lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore pasqyruar në tabelën më poshtë:

Për efekt krahasimi dhe mosrakordimit të detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 për sa raportuar nga Bashkia, sa paraqitur në pasqyrat financiare dhe SIFQ tabela si më poshtë:

Tabela nr.9, Situata Financiare për vitin 2022, 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		

b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	38,492		
a	Shpenzime korrente	5,693		
a,1	Mallra dhe shërbime	5,693		
a,2	Paga dhe sigurime			11.65 %
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	6,954		
b,1	Insitucione buxhetore	6,954		
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore	25,845		
c,1	Marrëdhënie pune	411		
c,2	Mallra dhe shërbime	2,784		
c,3	Investime	22,650		
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	38,492	330,513	11.65 %

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, cfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr.4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”⁷.

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2022, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.486 në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022”⁸.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 11.65 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2022.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç’ka do të thotë se Bashkia Pukë në fund të vitit 2022 rezulton në një situatë normale.

Stoku i detyrimeve nga Ministritë e Linjës është në vlerën 113,911 mijë lekë deri në 31.12.2022.

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore si dhe pasqyrimin e shpronsimeve në raportin e monitorimit dërguar në MFE.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 25,845 mijë lekë ose rreth 67% mbi totalin e detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2022 ka kryer likujdime në vlerën 7,032 mijë lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2022 Bashkia Pukë ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 57,557 mijë lekë, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Pukë.

⁷ Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

⁸ Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Pukë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

Si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore nga vitet e mëparshme për personat e larguar nga puna në fund të vitit 2022 janë në vlerën 411 mijë lekë të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhet dy persona.

-Gjithashtu konstatohet se për likuidimin e subjektit të mësipërm është nxjerrë urdhëri përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime Bashkisë Pukë.

Kriteri: Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Pukë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura, krijuar nga vendimet gjyqësore.

Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2022, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i radhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 104 raste për vlerën 38,492,096 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike nr.12, në Kapitullin “Aneke”.

Tabela nr.10, Përmbledhëse e faturave për vitin 2022

Artikulli	Sasia	Viti 2022/lekë
230-231	23	32,799,519
602	81	5,692,577
Totali	104	38,492,096

Burimi: Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 104 fatura të palikuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 38,492,096⁹ lekë.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Kriteri: Pikat 8, 106 dhe 107 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos

⁹ Analitikisht pasqyruar në Aneke.

likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

2.3.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Sektori i Financës për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Pukë ka marrë 2 financime projekti nga AKUM.

Tabela nr.11, Fonde të deleguara për vitin 2022 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2021, kanë vazhduar në vitin 2022 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2022, ose janë në proces gjatë vitit 2023

Nr	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Operat. Fitues	Dt. Lidhjes Kontrates	Ofert. Fituese Vlera kontr me Tvsh	Dt. e përfundimit kontratës	Situacionuar deri 31.12.2022	Likujduar 31.12.2022
1	Ujesjellesi i Fshatit Luf-Bashkia Puke	AKUM	J	17.05.2021	96,300,030	Perfunduar 22.01.2022	96,256,587	96,256,587
2	Ujesjellesi i fshatit Gjergjan-Bashkia Puke	AKUM	BOE "P" Sh.P.K & "L.T.E C" Sh.P.K	16.06.2021	173,788,484	Ne zbatim 80-90% e punime e mbaruar	75,917,768	74,876,982
	Totali				270,088,514		172,174,355	171,133,569

Burimi: Sektori i Financës Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për vitin 2021, Bashkia Pukë ka lidhur kontratë me OE "J" Shpk, për investim në punë publike me objekt "Ujësjetllësi i Fshatit Luf, Bashkia Pukë" me burim financimi nga AKUM. Vlera e investimit është 96,300,030 lekë, deri në 31.12.2022, për këtë objekt është likujduar nga fondet e përcjella nga AKUM në vlerën 96,256,587 lekë, si dhe punimet në këtë objekt kanë përfunduar dhe është marrë në dorëzim në datë 22.01.2022;

-Për vitin 2021, Bashkia Pukë ka lidhur kontratë me BOE "P" Shpk & "L.T.E C" Shpk, për investim në punë publike me objekt "Ujësjetllësi i Fshatit Gjergjan, Bashkia Pukë" me burim financimi nga AKUM. Vlera e investimit është 173,788,484 lekë, deri në 31.12.2022, për këtë objekt është likujduar nga fondet e përcjella nga AKUM në vlerën 74,876,982 lekë. Përgjatë vitit 2023 janë likujduar fondet e përcjella nga AKUM në vlerën 15,000,000 lekë dhe realizimi i punimeve deri në këtë fazë janë 80-90% e punimeve të përfunduara;

-Kontrata e mësipërme është regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Pukë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:

- Buxheti i Bashkisë Pukë dhe PBA, në përgjithësi është miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit për vitin 2022;

- Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;

- Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;
- Tavanet Përgatitore janë miratuar jashtë afateve;
- Për vitin 2022, nuk administrohet raporti i 4 mujorit të dytë për monitorimin e zbatimit të buxhetit
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;
- Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxhetit vjetor, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;
- Në PBA, si dhe buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në fondin pyjor;
- Për vitin 2022 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 87%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 “Tranferta Korente të Brendshme”, “Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ” duke vijuar me shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, kapitale të trupëzuara si dhe realizimin më të ulët e kanë mallra dhe shërbime të tjera. Vihet re se për vitin 2022 art. (602) mallra dhe shërbime të tjera paraqiten 65%, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.
- Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 25,844,918 lekë ose rreth 67% mbi totalin e detyrimeve të raportuara.
- Nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës pa shkaqe ligjore, rezulton se përgjatë vitit 2022 janë kryer likuidime të plota/pjesore, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet në vlerën 2,692,120 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona, si dhe për vendime gjyqësore për çështje të tjera janë likuiduar në vlerën 4,340,000 lekë.
- Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2022, ky afat nuk është respektuar në 104 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 38,492,096 lekë, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura. *Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi: z. Gj. Gj, ish Kryetari i Bashkisë Pukë dhe znj. F. P, ish Drejtore e Administrimit të Përgjithshëm.*

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Në Bashkinë Pukë, për vitin 2022 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr.48, nr.2356/2 prot., datë 05.01.2022, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr.30/2, datë 19.01.2022. ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i tatim - taksave.

-Sektori i tatim - taksave ka në përbërjen e saj, 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialist. Në datë 20.07.2022 specialisti z. Aleksander Frroku është larguar nga puna me urdhrin e Kryetarit të

Bashkisë me nr.206 prot., datë 20.07.2022, ky pozicion është vakant.

Struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave Bashkia Pukë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2022 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr., datë	Urdhri largimit Nr., datë	Pozicioni i punës
a	b	1	2	3	4	5	6
1	N. A	Pergjegjes	Ekonomik	Larte	Nr.117/30.06.2020	x	Pergjegjes zyre
2	E. Ç	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.188/10.11.2015	x	Specialist
3	R. N	Specialist	Mesuesi	Larte	Nr.47/20.02.2017	x	"
4	A. F	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.45/25.02.2021	206/20.07.2022	"
5	G. Ll	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.248/07.09.2022	x	"
6	Gj. M.	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.134/28.07.2016	x	"
7	S. M	Specialist	Ekonomik	Larte	Nr.284/23.10.2017	x	"

Burimi: Sektori i tatim-taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sektori i tatim-taksave Bashkia Pukë, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Pukë nga taksat dhe tarifet.

II.Taksat dhe Tarifet e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Pukë.

Përgjatë vitit 2022, për planifikimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore është hartuar dhe zbatuar 1 paketë fiskale, konkretisht:

-Paketa fiskale për vitin 2022 është miratuar me VKB nr.47, nr.2214/3 prot., datë 05.01.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.26/1 prot., datë 17.01.2022.

-Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Pukë, sipas sektorëve përkatës, në mënyrë të përmblendhur janë aplikuar/mbledhur rreth 23 lloje taksash dhe tarifash.

Për vitin 2022 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifet vendore në Bashkinë Pukë dhe NJA, ndahen në 4 kategori:

1.Biznes;

2.Ambulant;

3.Familjar;

4.Institucione.

Kategoritë e mësipërme (përfshiruar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:

-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh dhe Biznes i Vogël.

-Kategoria e tretë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim toka bujqësore, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid etj.

Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifet vendore, si dhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2022
1	Biznesi i Madh	45
2	Biznesi i Vogël	160
3	Ambulant (Hapësirat e tregut)	25
4	Institucione	19
	Total	250

Burimi: Sektori i tatim-taksave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i gjetjes: Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifet vendore për vitin 2022.

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në lekë, për vitin 2022, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2022		
		Plan	Fakt	%
I	Te ardhura nga Tatimet	1,579,000	3,310,000	210
1	Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin	1,579,000	3,310,000	210
II	Të ardhura nga Taksat	11,566,000	10,307,000	89
2	Taksa mbi B. Vogël	400,000	99,000	25
3	Taksa e Pasurisë, ndërtesë	3,384,000	2,260,000	67
4	Taksa mbi tokën bujqësore	124,000	204,000	165
5	Taksë mbi regjistrimin e Automjeteve	4,200,000	3,901,000	93

6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	1,045,000	1,272,000	122
7	Taksë table	704,000	678,000	96
8	Taksë hoteli	322,000	179,000	56
9	Tarifë parkimi	233,000	294,000	126
10	Tarifë për hapësira publike	534,000	563,000	105
11	Taksë reklame	0	40	0
12	Taksa të tjera (Tregu)	620,000	817,000	132
III	Të ardhura nga Tarifat	27,646,000	9,152,000	33
13	Tarifë pastrimi	7,951,000	6,475,000	81
14	Tarifë gjelberimi	284,000	162,000	57
15	Tarifë leje transporti	147,000	88,000	60
16	Tarifë vend banor/gjendje civile	0	28,000	0
17	Tarifë urbanistike	11,162,000	177,000	2
18	Tarifë regjistrimi biznes i Ri	0	0	0
19	Tarifë ndriçimi rrugor	1,256,000	1,077,000	86
20	Të ardhura të tjera (Linja Ajrore)	62,000	77,000	124
21	Tarifë për shërbimet shtesë nga MNZSH - ja	72,000	58,000	81
22	Tarifa të tjera (leje shfrytëzim karburantesh)	1,901,000	1,000,000	53
23	Tarifë çertifikimin mishi	0	0	0
24	Tarifë nga asetet në pronësi të bashkisë	4,711,000	0	0
25	Zhdëmtime	100,000	10,000	10
IV	Të ardhura të tjera	12,993,000	11,850,000	91
26	Qira trualli	797,000	651,000	82
27	Shitje Pasa&privatizim banese	0	140,000	0
28	Qira kullote	7,250,000	4,127,000	57
29	Tarifë uji i pijshëm	54,000	61,000	113
30	Të ardhura tenderi	0	0	0
31	Gjoha	203,000	82,000	40
32	Taksë Vule	0	0	0
33	Qira ndërtesë	3,816,000	3,215,000	84
34	Dhurata, sponsorizime & Garanci	0	2,577,000	0
35	Konvikt	115,000	100,000	87
36	Kopsht	505,000	497,000	98
37	Cerdhe	253,000	400,000	158
	GJITHSEJ (I+II+III+ IV)	53,784,000	34,619,000	64%

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2022 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **53,784 mijë** lekë dhe janë realizuar në vlerën **34,619 mijë** lekë, ose 64% / rreth 19,165 mijë lekë më pak nga plani.

-Në tabelën e mësipërme vihet re për disa lloje taksash dhe tarifash nuk planifikohet saktë niveli i arkëtimit/nuk ndryshon planifikimi, pavarësisht se në vitin e kaluar janë realizuar të ardhura, konkretisht për planifikimin e të ardhurave nga tarifë nga asetet në pronësi të bashkisë, psh., në vitin 2021 kjo taksë është planifikuar 4,711,000 lekë dhe janë arkëtuar 0 lekë, ndërkohë që përsëri në vitin 2022, kjo taksë është planifikuar në vlerën 4,711,000 lekë dhe realizimi është 0 lekë, gjithashtu Tarifa të tjera (leje shfrytëzim karburantesh) edhe pse janë dy subjekte të licencuara kjo tarifë parashikohet në shumën 1,900,000 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Kjo situatë tregon një nivel të ulët dhe punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022, të prokurohen pa fonde në dispozicion, duke rritur në fund të periudhave ushtrimore gjëndjen e faturave të palikujdurara dhe borxhin.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. Gj. Gj, ish Kryetar i Bashkisë Pukë dhe z. N. A, me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Pukë sipas kategorive të tyre.

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmblendhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Në fund të vitit 2021 (progresive)	Nr	Vlerë	Principial	Kamat-Vonesë	Gjohet e aplikuar
	100	21.039.527	11.579.967	1.326.005	
Biznesi i Madh	11	8,692,894	7,745,715	947,179	
Biznesi i Vogël	79	4,213,077	3,834,252	378,826	
NIPT Sekondar për punime të kryera	0	0	0	0	
Tarifa e licencimit për karburantet	0	0	0	0	
Tregëtar Ambulant	0	99,788	0	0	

Institucione	0	0	0	0	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	0	0	0	0	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	3	1,263,796	0	0	
Taksa e tokës bujqësore	0	0	0	0	
Gjopa të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0	
Gjopa të Policisë Bashkiake	0	0	0	0	
Qira trualli	0	0	0	0	
Qira objekti	0	0	0	0	
Qira fond pyjor dhe kullor	7	6,769,972	0	0	
Krijuar brenda vitit 2022	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë	Gjobat e aplikuara
Biznesi i Madh	3	145,938	0	0	
Biznesi i Vogël	10	81,047	0	0	
NIPT Sekondar për punime të kryera	0	0	0	0	
Tarifa e licencimit për karburantet	0	2,300,000	0	0	
Tregëtar Ambulant	0	0	0	0	
Institucione	0	0	0	0	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	936	411,353	0	0	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	0	130,164	0	0	
Taksa e tokës bujqësore	0	2,746,417	0	0	
Gjopa të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0	
Gjopa të Policisë Bashkiake	0	0	0	0	
Qira trualli	0	0	0	0	
Qira objekti	0	0	0	0	
Qira fond pyjor dhe kullor	0	0	0	0	
Në fund të vitit 2022 (progresive)	Nr	Vlerë	Principal	Kamat-Vonesë	Gjobat e aplikuara
Biznesi i Madh	12	8,838,832	7,881,439	951,393	
Biznesi i Vogël	80	4,349,128	3,969,702	379,426	
NIPT Sekondar për punime të kryera	0	0	0	0	
Tarifa e licencimit për karburantet	3	2,300,000	0	0	
Tregëtar Ambulant	0	44,784	0	0	
Institucione	0	0	0	0	
Familjar (për taksa dhe tarifa vendore)	0	411,353	0	0	
Taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale	12	1,393,960	0	0	
Taksa e tokës bujqësore	ne proces evidentimi	2,746,417	0	0	
Gjopa të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit	0	0	0	0	
Gjopa të Policisë Bashkiake	0	0	0	0	
Qira trualli	0	0	0	0	
Qira objekti	0	0	0	0	
Qira fond pyjor dhe kullor	0	6,769,972	x	x	
Total	107	26,854,446	11,851,141	1,330,819	

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2022 është 26,854,446 lekë për taksat dhe tarifave vendore, qiratë, gjobat, kamatëvonesa etj nga të cilat detyrime janë 25,523,627 lekë dhe kamat-vonesa janë 1,330,819 lekë. Në krahasim me fundin e vitit 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitoare me 5,814,919 lekë ose 22%.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Pukë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. Gj. Gj, ish Kryetar i Bashkisë Pukë dhe z. N. A, me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore.

III.1. Kategoria “Biznes” dhe “Institucione”.

Debitorët “Biznes” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, rezulton se në fillim të vitit 2022 kanë qenë debitor 100 subjekte të kategorisë “Biznes”, në vlerën 21,039,527 lekë.

-Në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 107 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën 24,108,029 lekë dhe në vlerën 2,746,417 lekë është detyrimi për taksën e

tokës bujqësore në vite për të cilën nga subjekti i audituar nuk është nxjerr numri i debitorëve, pra gjithësej 26,854,446 lekë për, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga sektori i tatim taksave Bashkia Pukë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese për të gjithë subjektet (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

Titulli i gjetjes: Gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në datë 31.12.2022.

Situata: Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve ndaj Bashkisë Pukë në vlerën gjithësej **26,854,446 lekë**, janë debitorë subjektet e biznesit të vogël dhe biznesit të madh gjithësej **107** subjekte në vlerën **24,108,029** lekë, dhe debitorë nga toka bujqësore në vlerën **2,746,417** lekë.

-Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave për bizneset që rezultojnë me status pasiv, nuk janë mbajtur akt- konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit.

-Në fund të vitit 2022 në krahasim me fillimin e vitit 2022, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” ka ardhur në rritje.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes dhe institucione) nga sektori i tatim taksave Bashkia Pukë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese për të gjithë subjektet (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. N. A, përgjegjës sektori i tatim taksave.

Kriteri: Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara”, të neneve 88 deri 104, Në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Pagesa e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të sheshtë transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga Sektori i Taksave dhe Tarifave, nuk është bërë kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 181 - Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”.

Impakti: Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Pukë dhe mos kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të subjekteve fizik/juridik, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura për **107** subjekte në vlerën **26,854,446** lekë, dhe debitorë nga toka bujqësore në vlerën **2,746,417** lekë.

“Subjektet qiramarrës”.

Qira për ndërtesën, fond pyjor, kullotë, gurore.

Bashkia Pukë administron 18 kontrata qiraje për ndërtesën, fondin pyjor, kullotë, gurore në NJA Pukë, Gjegjan, Qerret, Rrape , të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2012-2022 dhe me afat 1 deri në mbi 5 vite.

Në një vit buxhetor, të ardhurat që pret të arkëtojë Bashkia Pukë nga qiraja subjektet qiramarrës janë gjithësej 3,887,640 lekë. Nga auditimi i kontratave për dhënien me qira, u konstatua se në fund të vitit 2021 janë debitor 7 subjekte në vlerën 6,769,972 lekë.

Për arkëtimin e vlerës debitorë të krijuar nga mospagesa e qirasë, nuk administrohet dokumentacion mbi masat e marra, pra zgjidhjen e kontratës në zbatim të kapitullit “zgjidhja e kontratës” në kontratën e lidhur ndërmjet palëve, si dhe padi gjyqësore me qëllim ngarkimin e shërbimit përmbarimor, për ekzekutimin me forcë të detyrimit.

Nr.	Qiramaresi	Zona	Objekti i kontrat (HEC, gurore, agrikulturë, etj)	Afati Vjet	Kontrate	Debia progresive 31.12.2021	Detyrim vjetor lek/ha për vitin 2022	Paguar	Debia Progresive 31.12.2022
1	Xh. I	Puke	Ndertese	1	nr./ dt.03.01.2017	15.180	x	x	15,180
2	E. C	Puke	"	1	nr.42/13.01.2022	x	60,000	60,000	x
3	Shoqata "H. L"	Puke	"	1	nr.143/25.01.2019	x	19,200	19,200	x
4	'O-A" Sh.A	Puke	"	5	nr.25/217 , dt.22.05.2017	x	300,000	300,000	x
5	'O-A" Sh.A	Qerret	Fond Pyjor	9	nr.2011/02.11.2020	x	160,000	160,000	x
6	'O-A" Sh.A	Qerret	"	9	nr.51/18 , dt.06.08.2018	x	93,500	93,500	x
7	'O-A" Sh.A	Gjegjan	"	9	nr.2012/02.11.2020	x	300,000	300,000	x
8	"V" Sh.A	Qerret	"	5	nr.480/2 , dt.09.12.2015	x	337,500	337,500	x
9	"V" Sh.A	Gjegjan	"	5	nr.113/2 , dt.04.04.2014	x	300,000	300,000	x
10	"7S B F"shpk	Qerret	Kullote	5	nr.763/1, dt.22.05.2019	1,222,800			1,222,800
11	"E U" Shpk	Rrape	Fond Pyjor	mbi 5	nr.296/2, dt.06.05.2015	x	1,735,400	1,735,400	x
12	"G M " Shpk	Gjegjan	Kullote	mbi 5	nr.229/01.04.2021	x	65,500	65,500	x
13	"I" Shpk	Qerret	"	3	nr.167/1, dt.27.04.2017	475,531	x	x	475,531
14	"S-C" Shpk	Gjegjan	Fond Pyjor	3	nr.630/3, dt.18.04.2018	837,000	x	x	837,000
15	"D-1" Shpk	Qerret	Gurore	5	nr./dt.04.10.2012	266,079	x	x	266,079
16	"B" Sha	Qerret	Fond Pyjor	mbi 5	nr.26/03.02.2015	3,268,210	x	x	3,268,210
17	"Gj-K" Shpk	Gjegjan	"	1	nr.1688/12 , dt.24.10.2016	685,172	x	x	685,172
18	"M.C E G" Shpk	Gjegjan	"	1	nr.1418/8 , dt.22.08.2022	x	516,540	516,540	x
Totali						6,769,972	3,887,640	3,887,640	6,769,972

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.

Titulli i gjetjes: Keqmenaxhimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale.

Situata: Në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2022, i paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Pukë. Nga DVASHK Shkodër, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit

në infrastrukturë (TNI).

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës nuk është zbatuar pika 5 në paketën fiskale të Bashkisë Pukë për vitin 2022, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2022, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër situata ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe sa i përket arkëtimin të TNI për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2021, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe DAV Bashkia Pukë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, t'i përcillen sektorit të mbledhjes së borxhit, për të ndjekur procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Pukë konstatohet se:

-Vlera debitore progresive është 288,286 lekë për 10 subjekte (nga të cilat 2 subjekte për vlerën 57,572 lekë krijuar në vitin 2022).

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi z. N. A, përgjegjësi i sektorit të tatim taksave.

Kriteri: Ligji nr. 9482 datë 03.04.20106, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, neni 23, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim", pika 5, ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave vendore", i ndryshuar, neni 27 "Taksa e ndikimit në infrastrukturë", Paketa Fiskale 2022, Pika 5.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 288,286 lekë.

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Pukë, sektori i taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, të merren masa që të për të gjithë personat/subjektet të cilët janë pajisur me leje legalizimi, të aplikohet vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë, si dhe në raste të mos arkëtimin të ndiqen të gjitha procedurat ligjore përkatëse.

Për tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Pukë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Pukë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar;

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.3.2016 "Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)"

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Pukë dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2022-31.12.2022), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses,

Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;
 -Paketa Fiskale e vitit 2022 dhe Rregullore e brendshme e Bashkisë Pukë.
 -Gjithashtu u kryqëzua informacioni me databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial. institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve.

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2022 në Bashkinë Pukë.

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me Licenc		Licenc		Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer	Rinovuar Licenca (nëse në vitin 2022 i ka mbaruar afati)	Tarifa e aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer
				Po	Jo	Fillon	Mbaron					
1	"K" shpk	Puke	J.....P	Po	x	25.02.2019	24.02.2024	1,000,000	1,000,000	po		Po
2	"S. G " shpk	Puke	K....V	Po	x	05.04.2022	05.04.2027	1,000,000	1,000,000	Po		Po

Burimi: Drejtoria e Transportit, Bashkia Pukë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura në Bashkinë Pukë, për vitin 2022 ushtrojnë këtë aktivitet 2 subjekte. Nga auditimi i dosjeve përkatëse të subjekteve të mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2022 subjektet kanë paguar detyrimet për vitin fiskal në vlerën 2,000,000 lekë, ndërkohë rezultojnë debitorë për vlerën 2,300,000 lekë për periudhën deri në fund të vitit 2021.

Konkretisht subjektet janë:

1. "K" shpk me adresë Pukë, subjekt i cili është i pajisur me autorizim 5 vjeçar me nr.1, datë 25.02.2019 për tregtim me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm të cilit i mbaron afati në datë 24.02.2024.
2. "S. G" shpk me adresë Pukë, subjekt i cili është i pajisur me autorizim 5 vjeçar me nr.1, datë 05.04.2022 për tregtim me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm të cilit i mbaron afati në datë 05.04.2027.

Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Pukë.

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Pukë mbi arkëtimin e tarifës së ndotjes së mjedisit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike/private në Bashkinë Pukë, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Paketa fiskale e vitit 2022;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2022 - 31.12.2022;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit dhe përfundimit të punimeve;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa, sipas regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2022.

Bashkia Pukë në paketën fiskale të vitit 2022, ka përcaktuar tarifën e përkohshme të ndotjes së mjedisit, duke bërë dy kategorizime, si më poshtë vijon:

- 1.Tarifë për subjektet e ndërtimit person juridik duke aplikuar tarifë ndriçimi 2,500 lekë, tarifë gjelbërimi 1,000 lekë dhe tarifë pastrami 50,000 lekë. Për arkëtimin e kësaj tarife, është ngarkuar Sektori i Tatim-Taksave.
- 2.Taksa mbi truallin për bizneset aplikohet tarifa 12 lekë/m²/vit.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhimi i tarifave vendore për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Pukë.

Situata: Nga auditimi i veprimtarisë mbi faturimin dhe arkëtimin e tarifës së ndotjes, pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit dhe taksën mbi truallin u kryqëzua informacioni i marrë nga Njësia e Prokurimit (procedurat e prokurimit për punime ndërtimi dhe subjektet fitues), Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për njoftimin e fillimit dhe përfundimit të punimeve, lejeve të ndërtimit të dhëna, si dhe Drejtoria e të Ardhurave, për regjistrin e taksave dhe tarifave vendore, viti 2022, për kategorinë “biznes”.

Nga auditimi u konstatua se përgjatë periudhës 2022 nuk është tarifuar subjekti me nipt

sekondar subjekti D-1 me NIPT J..... për dy adresat për kryerjen punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Pukë, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë në vlerën 107,000 lekë.

Nr	Objekti i Prokurimit/Leja e Ndërtimit	Vlera e tenderit/Sip e punimeve	Zhvilluesi	OE/Subjekti ndërtues	NIPT	Kohëzgjatja e punimeve		Tarifa Ndotjes, Pastr,Gjelb,Nd
						Statusi 31.12.2022		
						Filluar	Mbaruar	(Lekë)
1	Ndërtim Trotuari dhe ndriçimi rrugor në segmentin Rotondo - Gjykata Puke	2,105,528	Bashkia Pukë	D-1	J.....H	2022-10-06	30.10.2022	53,500
2	Ndërtim Ura Kabash	2,770,678	Bashkia Pukë	D-1	J.....H	2022-07-22	26.08.2022	53,500
	Total	4.876.206						107.000

Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Pukë, Drejtoria i Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kriteri: Kreu II, pika 20 në Paketën Fiskale të Bashkisë Pukë.

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë në vlerën 107,000 lekë.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Pukë (shkëmbimi informacionit ndërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Drejtorisë së të Ardhurave), si dhe puna e pamjaftueshme e inspektimit në terren nga inspektorët e Drejtorisë së të Ardhurave.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Pukë, sektori i taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Njësinë e Prokurimeve, të merren masa që të për të gjithë subjektet të cilat kanë marrë punë publike në territorin e Bashkisë, të aplikohen tarifat vendore përkatese, si dhe në raste të mos arkëtimit të ndiqen të gjitha procedurat ligjore.

Bashkia Pukë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit prej 107,000 lekë, për subjektin D-1 me NUIS J....., si rezultat i mos aplikimit të tarifave.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Sektori i tatim-taksave për mostarifimin e subjektit D-1 në dy raste në të cilat ka kryer punime ndërtimi.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, znj. A. M, ish Drejtor i Administrimit dhe Zhvillimit të Territorit, z. N. A, Përgjegjës Sektori i Tatim-Taksave.

III.2.Familjet.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Pukë dhe NJA, për vitin 2022 janë taksuar 3.310 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile	Diferenca
Puke, Qelez, Rrapë	2.256	3.119	-863
Gjegjan	641	1.270	-629
Qerret	413	931	-518
Total	3.310	5.320	-2.010

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i tatim-taksave Bashkia Pukë me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjëndjes civile në Bashkinë Pukë dhe NJA janë 5.320 familje, pra ndërkohë në vitin 2022 janë taksuar 3.310 familje me një diferencë me 2010 familje të pataknuara.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Pukë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlogaritjet vetëm për tarifën e ndriçimit, gjelbërimit dhe sipas NJA për numrin e familjeve të pataknuara, do të kishim për

NJA Pukë 2,000 lekë * 863 familje mesatarisht taksuar më pak = 1,726,000 lekë planifikuar më pak, për NJA Gjergjan 700 lekë * 629 familje mesatarisht taksuar më pak = 440,300 lekë planifikuar më pak si dhe për NJA Qerret 700 lekë * 518 familje mesatarisht taksuar më pak = 362,600 lekë planifikuar më pak me **vlerë totale 2,528,900 lekë**.

- Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Pukë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Pukë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë dhe NJA.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Pukë, është marrëveshje bashkëpunimi me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A Shkodër-Pukë, i cili vepron si agjent tatimor për llogari të Bashkisë Pukë. Përjashtuar familjet e qytetit, në NJA taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. N. A, Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, znj. E. Q, z. G. Ll, z. Gj. M, z. R. N dhe znj. S. M agjent tatimor pranë NJA-ve.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Kreu II në Paketën Fiskale të Bashkisë Pukë.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i numrit të familjeve për efekt taksimi të tyre ndikon negativisht në fondet që mund të arkëtojnë Bashkia Pukë nga kategoria “Familjar”.

Shkaku: Mungesa e përditësimit të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për kategorinë familjar, si dhe mungesa e kryerjes së verifikimeve në terren nga sektori i tatim taksave Bashkia Pukë.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara të, për 2.010 familje të pa taksuara në vlerën 2,528,900 lekë.

-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Pukë, të marrë masat e nevojshme për krijimin e një regjistri mbi taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar”, duke pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme dhe evidentimin real të familjeve që jetojnë në Bashkinë Pukë.

Titulli i gjetjes: Debitorët “Familjar” të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Pukë.

Situata: Nga auditimi rezulton se në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive janë 936 familje debitorë për vlerën 293,643 lekë dhe në fund të vitit 2022 në mënyrë progresive janë 1.857 familje debitorë për vlerën 557,194 lekë, nga të cilat, në vitin 2022 është krijuar 263,551 lekë debi. Pra në krahasim me vitin 2021, në fund të vitit 2022 kemi rritje të vlerës debitorë për taksat dhe tarifatat për kategorinë “familje”, ç’ka tregon për performancë të dobët të Bashkisë Pukë në arkëtimin e taksave dhe tarifave të mësipërme.

-Sa i përket familjeve debitorë, rezulton se nuk janë marrë masa ligjore (njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor, bllokimin e llogarive bankare, etj) për arkëtimin e vlerës debitorë.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. N. A, Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, znj. E. Q, z. G. Ll, z. Gj. M, z. R. N dhe znj. S. M agjent tatimor pranë NJA-ve.

Impakti: Veprime që çojnë në mungesë të ardhurash në Buxhetin e Bashkisë Pukë dhe mos

kontabilizimi i debitorëve në pasqyrat financiare.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor në arkëtimin e detyrimeve nga debitorët.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Pukë të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin detyrimeve të pa arkëtuara, për **1,857** familje në vlerën **557,194 lekë**.

Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit të taksës së tokës bujqësore.

Situata: Nga auditimi i të dhënave mbi tokën bujqësore, sipas Sektori i Tatim - Taksave Bashkia Pukë janë Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Pukë për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësive Administrative të Bashkisë Pukë, pasqyrohet si me poshtë:

Nr	NJA	Sipërfaqja e tokës, ndarë me AMTP
1	Pukë	52
2	Gjegjan	300
3	Rrapë	251
4	Qerret	163
5	Qelez	188
	Shuma	954

Konkretisht planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga Sektori i Tatim-Taksave Bashkia Pukë, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Pukë

Kategoria e tokës	Sip/HA Nj.A. Puke /700 Ha	Sip/HA Nj.A. Gjegjan/500 Ha	Sip/HA Nj.A. Qerret/500 Ha	Sip/HA Nj.A. Rrape/500 Ha	Sip/HA Nj.A. Qelëz/500 Ha	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria III	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria IV	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria V	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria VI	0	0	0	0	0	0	0
Kategoria VII-X	29	78	23	22	40		101,800
Kategoria VIII	0	0	0	0	0	0	0
Total sip.Ha sipas planifikimit familjet rezidente	29	78	23	22	40	0	101,800

Sa më sipër konstatohet se në NJA Pukë, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 23 Ha më pak, në NJA Gjegjan, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 222 Ha më pak, në NJA Qerret, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 140 Ha më pak, në NJA Rrapë, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 229 Ha më pak, në NJA Qelëz, kemi keqplanifikim të taksës së tokës bujqësore, për arsye se sipërfaqja e cila përdoret për përllogaritjen e planit, është 148 Ha më pak, pra në total kemi 762 Ha më pak për përllogaritjen e planit, ku nëse do ta kthenim në vlerë monetare (çmimi minimal sipas paketës fiskale) = 381,000 lekë më pak duhet të ishte planifikimi i taksës së tokës bujqësore për NJA të sipërcituara.

Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. N A, Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, znj. E Q, z. G Ll, z. Gj. M, z. R. N. dhe znj. S. M agjent tatimor pranë NJA-ve.

Kriteri: Pika 7 në nenin 4, nenin 23 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i sipërfaqes së tokës bujqësore, çon në mos

planifikimin e saktë të kësaj, duke rritur shpresat për më tepër të ardhura dhe për rrjedhojë ndikon negativisht në planifikimin e shpenzimeve të Bashkisë Pukë.

Shkak: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Bashkia Pukë duhet të marrë masa për evidentimin e të gjithë personave të pajisur me certifikatë pronësie si dhe të krijohet një regjistër i taksës për tokën bujqësore ku të evidentohen të gjithë personat me të dhëna të sakta.

Nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Pukë, gjatë planifikimit të të ardhurave nga toka bujqësore të merren masa për saktësimin e sipërfaqes në vlerën 762 Ha, e llogaritur më pak në vitet e kaluara, ku me çmimin minimal sipas Paketës Fiskale korrespondon në vlerën 381,000 lekë, si e ardhur e munguar në Buxhetin e Bashkisë Pukë.

III.2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

➤ Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare 2022

Për të arritur në opinionin, nëse pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2022, konkretisht:

Pasqyrat Financiare të vitit 2022.

▪ Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2022 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat financiare të vitit 2022;
- Ditari i Bankës;
- Ditari i Arkës;
- Ditari i Magazinës;
- Ditari i Pagesave;
- Ditari i Veprimeve të ndryshme;
- Aktrakordimet me Degën e Thesarit Pukë;
- Situacionet dhe akt-marrjet në dorëzim të investimeve të kryera;
- Inventarët etj.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

▪ **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:

Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;

- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga znj. F. P;

➤ **Qasja dhe metodologjia e auditimit**

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të disponueshme dhe të siguruara nga vetë subjekti. Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës për vitin 2022 ka marrë në konsideratë vlerën 6,841,800 lekë për shpenzimet dhe 7,800,619 lekë për të ardhurat.

➤ **Mbi vlerësimin e riskut:**

Janë ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- **Kontrolli i brendshëm:** Kontrolli i brendshëm në Bashkinë Pukë nuk ka funksionuar i plotë, nuk përfshin gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim nuk ndihmon në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësisë ekonomike nuk mund ta dijë ku mund të ndodhin parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për t'i siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- **Konfirmimet nga të tretët:** Subjekti që auditohet ka rakorduar dhe konfirmuar me të tretët (me degën e thesarit) informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- **Transaksionet:** Janë kryer transaksione me vlera të rëndësishme me palë të treta, jo rutinë në periudhën e fundit të vitit ushtrimor. Nisur nga ky fakt, u filtruan të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës mbi këtë vlerë për muajt janar, shkurt, nëntor, dhjetor 2022, në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

➤ **Teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

- **Kontrolli aritmetik:** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

- **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:** Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi se shifrat e regjistruara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, në funksion të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:** Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- **Kontrolli i vlerësimit:** Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- **Kontrolli sipas një treguesi:** Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkojnë

fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: *mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, etj.*

➤ **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022:**

Mbajtja e kontabilitetit:

Për periudhën ushtrimore, pasqyrat financiare janë plotësuar sipas formateve standard të miratuara me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Bilanci i vitit 2022 është depozituar nga Dega e Thesarit Pukë në datën 29.03.2023 dhe është miratuar me nr. prot 117, datë 31.03.2023 brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj. Veprimet kontabël janë regjistruar në dokumentacionin bazë në ditarët përkatës, dhe më tej janë pasqyruar në pasqyrat financiare (bilanc). Janë mbajtur rregullisht ditarët e arkës, bankës, magazinës dhe veprimeve të ndryshme. Janë mbajtur dhe përditësuar rregullisht librat analitikë të të gjitha llogarive, përfshirë llogaritë inventariale të magazinës, për të cilat është bërë rakordimi llogari-magazinë. Janë përgatitur dhe hartuar pasqyrat financiare dhe statistikore së bashku me shënimet shpjeguese.

➤ **Mbajtja e kontabilitetit:**

Në këtë bashki, kontabiliteti nuk është organizuar me program financiar elektronik si është ai i Alpha Web etj., por është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale në formatin hard-copy.

Nga sektori i financës, janë hapur dhe mbajnë ditarët përkatës të bankës, të arkës, magazinës dhe i veprimeve të ndryshme etj.

Hartimi i pasqyrave financiare është bazuar në konceptet dhe rregullat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”), të përcaktuara në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, etj.

➤ **Hartimi i bilancit kontabël:**

Bilanci i hartuar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar të Bashkisë Pukë në fund të periudhës kontabël, për vitin ushtrimor 2022. Bilanci kontabël është ndërtuar nga tre pjesë: Aktivët, Detyrimet dhe Kapitali. Klasifikimi i elementeve të mësipërm në nëngrupe dhe paraqitja e bilancit është bërë bazuar në parimin e materialitetit për të siguruar pamjen e vërtetë dhe të sinqertë të situatës financiare. Situatë financiare në bilancin kontabël paraqitet e krahasuar me atë të periudhës paraardhëse dhe përmban kolonat me shumatat për periudhat përkatëse. Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nën zërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejt në pasqyrën e bilancit (*pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Pukë në datë 31.12.2022, sipas formatit F1, paraqiten në aneksin nr. 3, tabela nr.18, bashkëlidhur Projekt raportit*)

➤ **AKTIVET**

I. Aktivët Afatshkurtra

-Nga krahasimi dhe rakordimi i PF të disponueshme në Bashkinë Pukë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 2,071,378,806 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,959,819,666 lekë, me një diferencë prej 111,559,140 lekë më shumë në PF të subjektit. Në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në Bashki, vlera është 396,461,825 lekë, ndërsa në totalin e

Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 93,908,534 lekë, me një diferencë prej 302,553,291 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në PF të bashkisë ka vlerën 59,178,543lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0 (zero) dhe për pasojë këto llogari në sistemin e thesarit nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.

1. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre, PF2:

Konstatohet se kjo llogari gjatë vitit 2022 ka pësuar një rritje me 12,392,568 lekë në krahasim me viti paraardhës. Nga verifikimi i zërave të bilancit dhe krahasimi me PF në thesar, u konstatua se kjo llogari kuadron me shumën e llogarive përkatëse, të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit” dhe llogarisë 12 “Rezultatet e mbartura”. Nga auditimi i ditarit të bankës, u konstatua se, në debi të llogarisë 520 janë paraqitur gjithsej 923 transaksione, për vlerën të përgjithshme 525,694,951 lekë, ndërkohë që planifikimi ka qenë për vlerën totale 554,631,390 lekë ose shpenzimet janë realizuar 87 % të planit vjetor.

2. Gjendje Inventari qarkullues:

Llogaritë e inventarëve paraqiten në vlerën totale 21,733,093 lekë, me një rritje prej - 2,512,832 lekë nga viti 2021, të analizuara: Llogaria 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën 4,049,128lekë, me një rritje prej 783,417 lekë nga viti paraardhës 2021; llogaria 32 “Inventar i imët”, paraqitet në vlerën 16,136,947 lekë, me një rritje prej 319,849 lekë nga viti 2021; llogaria 35 “Mallra” paraqitet në vlerën 1,547,018lekë, me një rritje prej 1,409,566 lekë nga viti 2021. Nga rakordimi i listave bashkëlidhur urdhrit përkatës për inventarizimet, me kontabilitetin dhe pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të Aktiveve të Qëndrueshme, nuk rezultuan diferenca për sa i përket llogarisë 32 “Inventar i imët” dhe llogarisë 31 “Materiale”. Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e dokumentuara në aktin e rakordimit në fund të çdo viti, të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës, si dhe me vlerat e paraqitura në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

3. Llogaritë e arkëtuese:

Llogaritë e arkëtuese paraqiten në vlerën totale 72,175,441 lekë, me një rritje prej 9,988,238 lekë nga viti 2021. Vlerat e këtyre llogarive janë të barabarta me vlerat e paraqitura në bilancin e sistemit të thesarit.

Titulli i gjetjes: *Të ardhura të planifikuara të pa mbledhura nga taksat familjare, tarifa e lëshimit të autorizimeve për veprimtaritë e shitjes së karburanteve, etj.*

Situata: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerë debitorë 49,517,165 lekë nga vlera 43,436,069 lekë që paraqitej në viti 2021. (llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” pasqyrohet e detajuar në Pasqyrën PF5, bashkëlidhur aneksit nr.3, tabela nr.20 të Projekt raportit) Nga analiza e kësaj llogarie (468) rezultoi se, në fund të vitit 2022 kjo llogari është shtuar në vlerën 6,081,096 lekë. Kjo vlerë e shtuar ka të bëjë me rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH e cila përfaqësinë regjistrimin e detyrimeve në kontabilitet të të ardhurave të planifikuara të pa mbledhura nga taksat familjare (taksa e pronës, takes, pastirmit), tarifa e lëshimit të autorizimeve për veprimtaritë e shitjes së karburanteve, etj. Pra, kjo llogari përbëhet nga detyrimet që kanë subjektet e ndryshme dhe familjet ndaj bashkisë për taksat dhe tarifatat vendore. U vërejt se, gjatë vitit 2022 janë arkëtuar të ardhura të planifikuara vetëm 1,381,307 lekë, ndërsa për vlerën e pa arkëtuar, Bashkia Pukë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara.

Kriteri: Këto veprime janë në kundërshtim me Nenin 46 të ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet Administrative”, nenin 115 i Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 i Kodit Punës në Republikën e Shqipërisë.

Impakti: Mos mbledhja e të ardhurave nga tasat dhe tarifatat vendore ndikon negativisht në

buxhetin e Bashkisë Pukë.

Shkaku: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, dhe Zyra e Tatim – Taksave nuk ka nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat vendore.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Bashkia Pukë të ndjekë të gjitha rrugët administrative e gjyqësore për arkëtimin apo parashkrimin e debitorëve të ndryshëm të prapambetura nga vitet e mëparshme.

Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Zyrën e Tatim – Taksave dhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe të marrin të dhëna nga Ujësjiellës Kanalizime sh.a, Pukë apo dega e Operatorit të Shpërndarjes Elektrike (OSHE) Pukë, për të nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat që do të arkëtojnë për vitet në vazhdim.

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”, në fund të vitit 2022 paraqitet në bilanc në vlerën 22,658,276 lekë, e cila përbëhet nga shuma e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 4,743,934 lekë, llog.42 “Detyrimet ndaj personelit” në vlerën 12,844,235 lekë, llog.431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 745,525 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 3,692,761 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” në vlerën 505,619 lekë dhe llog. 427 “Ndalesa për detyrime ndaj të tretëve” në vlerën 12,000 lekë.

-Nga auditimi nuk u konstatuan diferenca midis vlerave të pasqyruara në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruar në llogaritë e pasivit. Pra, vlera e kësaj llogarie në bilanc është pasqyruar në mënyrë të drejtë në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

1. Të tjera aktive afatshkurtra:

Titulli i gjetjes: Nga Bashkia Pukë nuk janë parashikuar në buxhetet vjetore shpenzimet që do të bëjë për periudhat të ardhshme me qëllim shlyerjen e detyrimeve të krijuara.

Situata: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2022 paraqitet në vlerën **38,492,096 lekë** dhe gjatë vitit 2022 është pakësuar për vlerën 8,926,516 lekë.

Nga analiza, rezultoi se, kjo llogari është në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pasi vlera debitorë e kësaj llogarie, është e kuadruar dhe rakordon me shumën e llogarive kreditore në pasiv të bilancit. Po kështu vlera e kësaj llogarie sipas natyrës në bilanc është e barabartë me vlerën e paraqitur në Pasqyrat Financiare të disponueshme në sistemin e thesarit (llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF7, bashkëlidhur Projekt raportit në aneksin nr. 3, tabela nr.19).

Mirëpo, vërehet se, detyrimet e prapambetura që janë gjendje në fund të vitit 2022 në vlerën 38,492,096 lekë, një pjesë e konsiderueshme e tyre përbëhet nga detyrimet e pa shlyera dhe të trashëguara nga Bashkia Pukë dhe nga ish-Komunat e tjera para reformës territoriale administrative, pra para vitit 2016. Siç tregohet gjendja e detyrimeve të paslyera është relativisht e konsiderueshme për buxhetin e kësaj Bashkie e cila nuk është e angazhuar maksimalisht për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për ti planifikuar ato në çdo vit buxhetorë, me qëllim likuidimin e tyre pjesë-pjesë deri në shuarjen e plotë të tyre.

Kriteri: UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Impakti: Mos shlyerja e detyrimeve brenda afateve ligjore sjell vështirësi financiar dhe ndikon negativisht në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Bashkia Pukë dhe ish-Komunat që janë përthithur nga kjo bashki nuk kane shlyer

për çdo vit brenda afateve ligjore detyrimet të krijuara gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Bashkia Pukë, për çdo vit, gjatë planifikimeve buxhetore të parashikoj në buxhetet vjetore fonde për shlyerjen pjesore të detyrimeve të prapambetura, deri në shuarjen e plotë të tyre.

II. Aktivet Afatgjata

1. Aktivet afatgjata jo materiale:

Titulli i gjetjes: *Nuk janë realizuar 5 projekte për punë publike në vlerën 1,137,600 lekë të hartuara dhe financuara nga bashkia gjatë viteve të mëparshme.*

Situata: Në këtë grup të bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive jo materiale afatgjata sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018. Ky grup përfshin, rimbursimit të huave, studime dhe kërkime, koncesione, patenta, licenca dhe të ngjashme dhe paraqiten në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” e cila në datën 31.12.2022 është me gjendje në vlerën 1,137,600 lekë. Kjo llogari deri në këtë datë, përbëhet nga 5 studime e projekte në vlerën 1,137,600 lekë, nga të cilat 593,835 lekë janë projekte të trashëguara që nga ish-komunat të pa zbatuar dhe realizuar, ndërsa 543,765 lekë janë projekte të hartuara gjatë vitit ushtrimor në Bashkinë Pukë. Paraqitja në bilanc të tyre bëhet për vlerën neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar, pasi deri në fund të vitit 2022 rezultoi se, asnjë nga këto projekte nuk është financuar dhe nuk është realizuar. Për këtë arsye bashkia nuk ka përlllogaritur norma amortizimi për këto objekte, pasi sipas Standardeve të Kontabilitetit (SKK-05), kostot e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivit (investimit), pra amortizohen së bashku me totalin e investimit të ndërtimit të aktivit (studimi + projektimi + zbatim + mbikëqyrje + kolaudim). Kjo llogari paraqitet si më poshtë:

Nr.	Llogaria 202	Vlera
1	Studim projektim kanali Bushat	399,600
2	Studim projektim Ujesjellesi Bicaj	138,000
3	Studim projektim Ura Kavlibne	300,000
4	Studim projektim rruga Lumzi	300,000
5	Studim projektim kanali Bushat	399,600
Totali		1,137,600

Burimi: Bashkia Pukë

Kriteri: UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Impakti: Mos realizimi i projekteve për punë publike ka sjell përdorim pa efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve për hartimin e këtyre projekteve.

Shkak: Bashkia Pukë nuk ka bërë përpjekje për të gjetur burime financimi për realizimin e këtyre objekteve.

Rëndësia: I Mesëm

Rekomandimi: Bashkia Pukë, në buxhetin e vitit 2024, të planifikojë fonde nga të ardhurat e veta apo ti kërkojë mbështetje buxhetore pushtetit qendror për investimin dhe realizimin e këtyre projekteve.

2. Aktive afatgjata materiale:

Në këtë grup të bilancit paraqiten aktivet që plotësojnë kushtin e njohjes së tyre si aktive materiale afatgjata sipas kërkesave të SKK 5. Paraqitja në bilanc është bërë për vlerën neto të tyre duke zbritur amortizimin dhe zhvlerësimi i akumuluar. Vlera e kësaj nën rubrike është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit. Shtesat në këtë nën rubrikë përfaqësojnë vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstrukcione dhe shtesat gjatë periudhës, ndërsa vlerat e pakësimit janë vetëm për vlerën e amortizimit. Bashkia disponohen dokumente në lidhje me pasuritë publike të transferuara në vite me VKM të posaçme në komunat të cilat sot janë pjesë e Bashkisë Pukë.

-Gjendja e llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë pandryshuar nga vitit 2021.

-Gjendja e llogarisë 211 “*Pyje kullota plantacione*” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 6,325,301 lekë, me një pakësim prej 1,224,325 lekë nga viti ushtrimor 2021.

Titulli i gjetjes: Në disa objekte janë kryer punime të ndryshme, por këto vlera nuk i janë shtuar vlerës totale të objektit.

Situata: Gjendja e llogarisë 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 653,691,341 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 158,595,509 lekë në krahasim me vitin 2021 që ka qenë në vlerën 495,095,832 lekë. Në vitin 2022, ne zbatim te rekomandimit të KLSH është shtuar vlera e objektit ‘Rikualifikim Urban me vlerë 175,687,230 lekë financuar nga FZSHS e cila ishte e paregjistruar në vitet e mëparshme (llogaria 212 “*Ndërtesa e Konstruksione*”, paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF7, bashkëlidhur Projekt raporti, në aneksin nr.3, tabela nr.19).

Gjendja e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 584,684,266 lekë nga vlera 533,846,313 lekë që ishte në fund te viti 2021, duke u shtuar në vitin ushtrimor për 50,837,953 lekë nga vitit paraardhës. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa vlera e pakësimit janë vetëm për vlerën e amortizimit (llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF14, bashkëlidhur Projekt raporti, në aneksin nr.3, tabela nr.22).

Nga analiza e këtyre dy llogarive (212 dhe 213) rezultoi se, vlerat e tyre neto sipas objekteve korrespondojnë me llogaritë sintetike të paraqitura në pasqyrat financiare. Por, u vërejt se, në disa objekte ekzistuese që janë kryer punime të ndryshme në vitin ushtrimor dhe në vitet e mëparshme, nuk i është shtuar vlera e këtyre punimeve vlerës totale të objektit. Këto punime (investime) janë regjistruar në llogarinë analitike të kësaj llogarie veçmas, vetëm për vlerën e investimit të kryer pa emërtuar saktësisht objektin në të cilin është kryer punimi, në kundërshtim me ligjin për ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Konkretisht këto punime janë kryer në: Godinën e Zhvillimit Rural dhe Turizmit, në vlerën 369,360 lekë, në Vend depozitim i Mbetjeve Fushë Qarri në vlerën totale 1,192,260 lekë, respektivisht në tre raste, Mbetje Urbane me vlere 389,760 lekë, Mbetjet Fushë Qarri në vlerën 562,560 lekë, shtyrje e ngjeshje mbetje në vlerën 239,940 lekë dhe në Shëtitoren e Liqenit, “Blerje dhe vendosje Pllaka” me vlere 1,151,992 lekë.

Kriteri: Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Impakti: Mos pasqyrim i sakte i vlerës së asetëve dhe mos llogaritja e amortizimit të tyre

Shkak: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm nuk ka bërë regjistrimet kontabël në librat e llogarisë duke mos i shtuar vlerës së objekteve ekzistuese edhe vlerat e punimeve të tjera të kryera në këto objekte.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Për rastet konkrete të sipërcituara apo për çdo rast tjetër të mëparshëm që mund të evidentohet, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bëjë regjistrimet kontabël përkatëse në librat e llogarisë duke i shtuar vlerës së objekteve ekzistuese edhe vlerat e punimeve të kryera në këto objekte.

-Gjendja e llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 18,461,719 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 16,476,855 lekë me një pakësim në vlerën 1,984,864 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa vlera e pakësimit janë për vlerën e amortizimit.

-Gjendja e llogarisë 215 “*Mjete transporti*” në datën 31.12.2022, ka qenë në vlerën 9,700,398 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,686,997 lekë, me një pakësim në vlerën 986,599 lekë. Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për mjete transporti, ndërsa vlera e pakësimit janë për vlerën e amortizimit. Nxjerrje jashtë përdorimit nuk ka. Nga analiza analitike e kësaj llogarie, u konstatua se vlera është 9,700,398 lekë, e njëjtë me vlerën e paraqitur në bilanc. Nga verifikimi i regjistrave analitik, u konstatua se për dy llogaritë e mësipërme (2014 dhe 2015), nuk u paraqitën problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Vlen të theksohet se, ka pasur probleme të trashëguara nga regjistrat kontabël të aktive të ish-komunave, por për vitin ushtrimor, ato janë rregulluar duke u përshkruar me, datat e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëparshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit, etj.

-Gjendja e llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 23,957,944 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 20,256,246 lekë, me një amortizim të akumuluar 55,536,099 lekë, me shtese në vlerën 1,738,588 lekë dhe pakësim me vlerë 36,870 lekë (në vlerë neto). Shtesat në këtë llogari paraqesin vlerën e investimeve të kryera ndër vite për materiale inventari si dhe shtesat e tjera gjatë periudhës, ndërsa vlerat e pakësimit janë për vlerën e amortizimit.

-Për vitin 2022, amortizimi i AQT-ve, Llogaria 219 “*Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara*”, nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre. Llogaritja e amortizimit është bërë dhe bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar; UMF nr. 5, datë 30.01.2006 “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar, pika 3.7 “*Amortizimi*”, si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*”, i ndryshuar. Nga auditimi i pasqyrave mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto, u konstatua se, amortizimi i akumuluar për Aktivet Afatgjata Materiale në fillim të vitit 2022 paraqitet për vlerën 711,513,053 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet për vlerën 775,642,022 lekë. Nga PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera e llogarisë 219 “*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*”, është 0 lekë.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto të kategorive përkatëse të aktiveve, të regjistruar në çelje të periudhës ushtrimore, shtesën e koston së blerjes dhe zbritjen e vlerë kontabël neto të aktiveve të shitura, apo të dala jashtë përdorimit për kategoritë përkatëse të aktivit (*gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto janë paraqitur në Formatin nr.7/a dhe Formatin nr.7/b bashkëlidhur Projekt Raportit, në aneksin nr.3, tabela nr.23 dhe tabela nr.24*).

3. Aktivet Afatgjata Financiare:

Aktivët Afatgjata Financiare, në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën 140,923,000 lekë dhe kjo vlerë kuadron dhe rakordon me vlerën e pasqyruar në PF të sistemit të thesarit. Kjo vlerë përbëhet nga vlera e aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Pukë Sh.a dhe Futboll Klub Tërbuni Sh.a.

2. Investimet:

-Gjendja e llogarisë 230 “*Investime për aktive afatgjata jo materiale*” dhe 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” në datën 31.12.2022 paraqitet: llogaria 230 me 0 lekë dhe llogaria 231 në vlerën 240,553,912 lekë. Po kështu dhe në datën 31.12.2021 llogaria 230 kanë qenë

me 0 leke dhe llogaria 231 kanë qenë në vlerën 273,956,434 lekë. Në PF të disponueshme në sistemin e thesarit, vlera totale e investimeve është 240,553,912 lekë, respektivisht: 0 lekë llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 240,553,912 lekë llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”. Si rregull, këto llogari paraqesin vlerën e investimeve në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afatgjata materiale” (llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF19, bashkëlidhur projekt raportit, në aneksin nr.3, tabela nr.25)

➤ **PASIVET**

I. Pasivet Afat shkurtra

1. Llogari të pagueshme:

-Në këtë grup llogarish paraqiten të gjitha detyrimet që ka Bashkia ndaj të tretëve për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me pagesë të mëvonshme e cila është gjendje në fund të vitit 2022 në vlerën 61,150,372 lekë. Nga analiza e detajuar e këtyre llogarive rezultoi se:

-Llogarive 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, paraqitet 17,391,112 lekë nga të cilat 12,647,178 lekë janë detyrime të prapambetura (llogaria 401-408 “Furnitorë për mallra, produkte e shërbime” e detajuar paraqitet në Pasqyrën PF21, bashkëlidhur projekt raportit, në aneksin nr.3, tabela nr.26).

-Llogaritë kreditore 42; 431; 435 dhe 436 në vlerën totale 17,800,140 lekë, përfaqësojnë detyrime e Bashkisë Pukë për pagat e personelit, kontribute për sigurime shoqërore, shëndetësore si dhe tatimin mbi pagë, të përlllogaritura për pagesë në muajin dhjetor 2022, të cilat janë likuiduar me pagesat e kryera në muajin janar 2023, respektivisht: llogaria 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabël për vlerën 12,856,235 lekë, përfaqëson detyrimet ndaj punonjësve për pagat e personelit për muajin dhjetor 2022; llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatime e taksa”, analizuar e kuadruar me gjendje kontabël për vlerën 745,525 lekë, përfaqëson detyrimet për tatimin mbi pagat e personelit në muajin dhjetor 2022; llogaria 435 “Sigurime shoqërore”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabël për vlerën 3,692,761 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore në muajin dhjetor 2022; llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”, e analizuar dhe kuadruar me gjendje kontabël për vlerën 505,619 lekë, përfaqëson detyrimet për kontributet e sigurimet shëndetësore në muajin dhjetor 2022.

Titulli i gjetjes: Në disa objekte kanë përfunduar punimet, por nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të tyre si dhe nuk është bërë kthimi i garancisë së punimeve.

Situata: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 16,466,033 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është në vlerën 13,842,857 lekë ose me zbritje në vlerën 2,623,176 lekë. Vlera e kësaj llogarie përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga krahasimi i PF të Bashkisë me PF të sistemin e thesarit, u konstatua se vlera e tyre është e njëjtë në të dyja pasqyrat (llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF23, bashkëlidhur Projekt raportit, në aneksin nr.3, tabela nr.27).

U vërejt se, për disa objekte në të cilat kanë përfunduar punimet, janë paraqitur situacionet përfundimtare, janë kolauduar, janë bërë likuidimet në përputhje me kontratat e sipërmarrjeve si dhe janë regjistruar vlerat përkatëse të tyre në kontabilitet, por Bashkia nuk ka ngritur komisionet përkatëse për marrjen përfundimtare në dorëzim të tyre, duke bllokuar kështu kthimin e garancive të punimeve për objektet e përfunduara, ndaj sipërmarrëseve.

Kriteri: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” .

Impakti: Mos kthimi i vlerave të garancive të punimeve nuk pasqyron gjendjen reale të kësaj llogarie si dhe ndikon negativisht në financat e sipërmarrësve të punimeve.

Shkak: Bashkia Pukë nuk ka ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve për pasojë nuk është bërë kthimi i vlerave të garancive të punimeve.

Rëndësia: I ulët

Rekomandimi: Bashkia Pukë, për çdo objekt të përfunduar dhe të kolauduar, në përfundim të periudhës së garancisë të punime, të ngrejë komisione të posaçme për marrjen në dorëzim të objekteve dhe të bëjë çlirimin e garancisë së punimeve.

Titulli i gjeties: Mos pagesa e detyrimeve brenda afateve të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore, ka sjell vështirësi financiare dhe rritjen e kostove buxhetore të Bashkisë Pukë.

Situata: Gjendja në datën 31.12.2022 e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” është në vlerën 25,959,120 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 ka qenë 7,776,939 lekë me rritje në vlerën 18,182,181 lekë. Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e sistemit të thesarit. Në mënyrë analitike, kjo llogaria paraqitet, si më poshtë:

Nr	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Nr. i faturës	Data origjinale e fatures	Vlera e detyrimit ne 31.12.2021	Shtesat gjate vitit 2022	Shlyerjet gjate vitit 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Demshperblim per largim nga puna U P	Permbarues Gjygsor E M Shkoder	130	04.07.2012	134,000			134000
2	Demshperblim per largim nga puna M F	M F	2559	25.06.2018	493,220		493,220	0
3	V.GJ det 163 date 09.02.2015	"B" SHPK Z.Permb Puke	206	21.12.2011	4,076,217		1,750,000	2,326,217
4	F L VGJ	E. shpk Permbar Gjygsor	E/132	30.04.2018	140,000		140,000	0
5	Vgj per det kopeshti dhe Q sociale	Z		17.01.2017	457,511		0	457,511
8	H Ll	VGJ H Ll	4449	06.12.2018	987,091		710,000	277,091
10	RIGJENERIM I SHETITORES PUKE	U N	7	25.03.2018	22,994,495	1,655,604	2,000,000	22,650,099
	Shuma V.Gjygsore 31.12. 2022				29,282,534	1,655,604	5,093,220	25,844,918

Në këtë llogari janë pasqyruar të gjitha detyrimet që kanë rrjedhur nga mos ekzekutimet e vendimeve gjyqësore kryesisht për pagesat për moszbatim të kontratave të lidhura dhe për pagesat e dëmshpërblimeve ndaj punonjësve për largimet nga puna. Pjesën më të konsiderueshme të kësaj llogarie ose 94% të saj, e zë vlera prej 22,650,099 lekë që Bashkia ka ndaj shoqërisë “U N”. Në vitin 2021 kjo fature ka qenë e pasqyruar në llogarinë 401 408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” për detyrimin e pa likuiduar që i kishte bashkia këtij subjekti në zbatim të kontratës së ndërtimit për “Rigjenerim të shëtitores së Qytetit Puke. Në vitin 2022 në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Urdhrit të Ekzekutimit të detyrueshëm të zyrës Përmbartimore është regjistruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Ky detyrim është krijuar që në vitin 2018, pasi ndërmjet shoqërisë “U N” dhe Bashkisë Pukë është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr.1421/13, datë 07.10.2016 për “Rigjenerimin e Shëtitores Qendrore Pukë”. Mbas një viti është nënshkruar përsëri një kontratë shtesë me nr.1421/18, datë 18.10.2017. Shtesa e kontratës është në vlerë 22,994,496 lekë, me afat likuidimi gjatë vitit financiar 2018 dhe financimi do të bëhet nga fondet e Bashkisë Pukë. Në përfundim të punimeve në zbatim të kontratës shtesë, shoqëria “U N” ka lëshuar faturën tatimore nr. 7 date 25.03.2018 në vlerën e plotë të saj, prej 22,994,496 lekë. Bashkia Pukë, nuk ka bërë likuidimin e kësaj fature në shkelje të kushteve të kontratës shtesë. Në kushtet e mos përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, shoqëria “U N” i është drejtuar gjykatave për lëshimin e urdhër ekzekutimit për titullin ekzekutiv të faturës tatimore nr. 7 date 25.03.2018. Në përfundim të proceseve gjyqësore, Gjykata Administrative e Apelit me vendimin e formës së prerë nr.58, datë 08.06.2022, ka Vendosur që Bashkia Pukë ti paguaj shoqërisë “U N” faturën tatimore nr. 7 date 25.03.2018 në vlerën e plotë të saj prej 22,994,496 lekë. Për mungesë fondesh Bashkia nuk ka bërë ekzekutimin e vendimit të gjykatës dhe të tarifës përmbartimore dhe për këtë arsye, me urdhër të zyrës përmbartimore nr.477, datë 02.09.2022 është urdhëruar Dega e Thesarit Pukë të vendosë

sequestro konservative të llogarisë “602” të Bashkisë Pukë për ekzekutimin e vlerës 24,650,099 lekë. Pra, vlera e detyrimit prej 24,650,099 lekë përbëhet, nga detyrimi i pa likuiduar sipas faturës tatimore nr. 7 datë 25.03.2018 në vlerën 22,994,495 lekë dhe nga tarifa e shërbimit përmbarimor në vlerën 1,655,604 lekë.

Si konkluzion, nga mos pagesa e detyrimit prej 22,994,496 lekë, brenda afateve të përcaktuara në kontratën shitesë me nr.1421/18, datë 18.10.2017, janë rritur padrejtësisht kostot buxhetore për Bashkinë Pukë në vlerën 1,655,604 lekë dhe ngarkohet me përgjegjësi Ish-Kryetari i Bashkisë z. Gj. Gj.

Kriteri: Neni 16, i ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare” dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Impakti: Vështirësi financiare dhe rritje e kostos buxhetore.

Shkaku: Bashkia Pukë nuk ka bërë pagesa për kryerjen e punimeve brenda afateve të përcaktuara në kontratën e lidhur.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës për të analizuar dhe verifikuar vlerësimin e rezultateve të kësaj analize si dhe të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për punonjësit përgjegjës për dëmin e shkaktuar dhe për vështirësinë financiare që i është shkaktuar Bashkisë Pukë në vlerë 1,655,604 lekë.

2. Aktive (detyrime) të tjera afatshkurtër:

Në këtë grup të detyrimeve afatshkurtra paraqiten shpenzimet e kryera nga bashkia dhe që në zbatim të parimit të përputhjes së të ardhurave me shpenzimet, ende nuk janë njohur si shpenzime nga njësia ekonomike. Po kështu, njësia ekonomike përfshin në këtë grup edhe të gjitha detyrimet e llogaritura për të paguar interesat e maturuara ekonomikisht.

-Gjendja e llogarisë 419 “*Kreditorë, parapagime*” në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 204,200 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 288,537 lekë ose me rritje në vlerën 84,337 lekë. Vlera e kësaj llogarie është e barabartë me vlerën e paraqitur në bilancin e disponueshëm në sistemin e thesarit.

➤ Kapitali

Sipas përcaktimit të bërë në SKK, kapitali rezulton si diferencë e aktiveve me detyrimet e njësive ekonomike. Në zbatim të këtyre standardeve, bazuar në parimin e materialitetit, janë pasqyruar elementët përbërës të kapitaleve të veta, si më poshtë:

-Gjendja e llogarisë 101 “*Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar*” (Kapitali i nënshkruar) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,251,180,638 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 1,453,294,793 lekë ose me rritje në vlerën 202,114,155 lekë.

-Gjendja e llogarisë 85 “*Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore*” (*Humbja/fitimi i ushtrimit*) në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 41,248,514 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 47,848,518 lekë ose me rritje në vlerën 6,600,004 lekë. Në këtë zë paraqitet rezultati i periudhës rrjedhëse ushtrimore ashtu si rezulton nga pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve.

-Llogaritë 105 “*Teprica e Granteve kapitale të brendshme*” në datën 31.12.2021 ka qenë në vlerën 273,956,434 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 240,553,912 lekë ose me ulje-rritje në vlerën -33,402,522 lekë dhe 106 “*Teprica e Granteve kapitale të huaja*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 1,467,802 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 12,575,881 lekë ose me rritje në vlerën 11,108,079 lekë.

Grantet kapitale të brendshme, mbeten me tepriçë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces të institucioneve (të papërfunduara ose të pa marra në dorëzim). Në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e

llogarive 23. Këto mbyllen (kapitalizohen) me fondet bazë në kohën kur investimi është përfunduar dhe objektet janë marrë në dorëzim.

-Pasqyra e performancës financiare. Sipas SKK, në pasqyrën e performancës përfshihen të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në një periudhë ushtrimore kontabël. Ky standard siguron trajtim të ndryshëm për: parimet e përgjithshme për përgatitjen e Pasqyrave Financiare; për efektin e ndryshimeve të kurseve të këmbimit; për aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale; për Instrumentet Financiare, etj.. Nuk u konstatua mos respektim të SKK.

➤ **Të Ardhurat**

1. Të ardhura nga taksat dhe tatimet:

-Llogaria 70 “*Të ardhurat nga taksat e tatimet*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 11,077,058 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 12,741,433 lekë ose janë mbledhur më pak të ardhura gjatë vitit 2022 në vlerën 1,664,375 lekë.

-Llogaria 71 “*Të ardhura jo tatimore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 14,354,795 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 15,989,829 lekë ose me rritje në vlerën 1,635,034 lekë.

2. Të ardhura të tjera:

-Llogaria 72 “*Grante korente*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 364,473,781 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 383,745,342 lekë ose me rritje në vlerën 19,271,561 lekë.

-Në zërin “*Të Ardhura të tjera*”, në llogarinë 787 “*Tërheqje nga seksioni i investimeve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 39,103,442 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 55,444,504 lekë ose me rritje në vlerën 16,341,062 lekë.

-Në llogarinë 63 “*Ndryshimi i gjendjes së inventarit të produkteve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën -157,033 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është -2,512,832 lekë ose me rritje në vlerën -2,355,799 lekë.

➤ **Shpenzimet**

1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

-Llogaria 600 “*Pagat dhe përfitimet e punonjësve*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 151,878,241 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 158,426,292 lekë ose me rritje në vlerën 6,548,051 lekë.

-Llogaria 601 “*Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 25,591,594 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 26,275,582 lekë ose me rritje në vlerën 683,988 lekë. Konstatohet se, këto shpenzime janë të kuadruara dhe rakorduar me Degën e Thesarit Puke dhe janë në të njëjtën vlerë.

Sipas listëpagesave për vitin 2022 janë paguar mesatarisht 293 punonjës për Bashkinë Pukë dhe nuk u konstatua tejkalim të fondit të pagave.

2. Blerje mallra dhe shërbime:

Kjo llogari përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së Bashkisë. Llogaria 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*”, në datën 31.12.2021, ka qenë në vlerën 39,382,015 lekë, ndërsa në datën 31.12.2022 gjendja e kësaj llogarie është 42,042,802 lekë ose me ulje në vlerën 2,660,787 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduar me Degën e Thesarit Puke me të njëjtën vlerë (llogaria 602 “*Blerje mallra dhe shërbime*” paraqitet e detajuar në Pasqyrën PF31, bashkëlidhur Projekt Raportit, në aneksin nr.3, tabela nr.28)

➤ **Veprimet e kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.**

1. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike

në ditarin e bankës, në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues, të konfirmuara nga nëpunësi i thesarit dhe të vulosura nga të dyja palët.

Urdhër-shpenzimet janë përpiluar në bazë të dokumenteve vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit, si urdhër prokurimi, proces-verbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzime përputhen me vlerat e dokumenteve financiare që mbështesin shpenzimin përkatës. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë, kronologjikisht, sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë regjistrimi i artikujve kontabël.

2. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës:

Bashkia Pukë ka në funksion dhe kryhen veprime financiare nëpërmjet arkës në lekë. Nga auditimi rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare të ndryshme, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare dhe gjoba të policisë bashkiake, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore. Në vitin 2022, nga arka janë kryer transaksione pagese për kthime të parapagimeve të tarifës për kopshtet dhe çerdhen Pukë. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkën dhe specialiste e financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës. Gjate vitit janë prerë Mandat Arkëtime në vlerën 4,699,384 lekë dhe libri i arkës është mbyllur me Mandat Arkëtimin nr. 1098 date 30.12.2022. Të ardhurat nga arkëtimet e kryera për vitin 2022 janë derdhur në mënyrë periodike në bankë dhe gjendja e arkës në fund të çdo muaji dhe në fund të vitit ka qenë 0 (zero) lekë.

➤ Administrimi i aseteve dhe procedura e inventarizimit

1. Administrimi i aseteve dhe regjistrimi i tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Titulli i gjetjes: *Sektori i financës nuk dispononte të dhëna për regjistrimin e pronave në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.*

Situata: Për vitin 2022, nuk u paraqitën problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh (aseti) në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Të gjitha asetet janë mbajtur në librat analitik duke i përshkruar me të dhëna si: datat e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlera e blerjes, vlera e investimeve të mëparshme të cilat sjellin rritje të vlerës së asetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, etj. Ndërsa në lidhje me regjistrimin e aseteve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës në pronësi të Bashkisë Pukë, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (sektori i financës) nuk dispononte të dhëna dhe nuk ka dokumentacion se sa prona të kësaj bashkie janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe në çfarë faze është procesi i regjistrimit të tyre dhe sa është vlera financiare që duhet për regjistrimin e tyre.

Kriteri: Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Impakti: Mos pasqyrim reale i vlerësimit të pronës dhe pamundësi e përdorimit të tyre nga të tretën në përfitim të Bashkisë.

Shkaku: Mungesa e burimeve financiare të Bashkisë

Rëndësia: I Ulët

Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bashkëpunoi dhe koordinoj punën me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike në Bashkinë Pukë për regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2. Procedurat e inventarizimit

Titulli i gjetjes: *Mos përfundim të procedurave për nxjerrjen materialeve jashtë përdorimit*

Situata: Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 336 date 09.12.2022 është ngritur grupi i punë për kryerjen e inventarizimit fizik të aseteve dhe materialeve, në pronësi të Bashkisë Pukë.

Në përfundim të procesit të inventarizimit nuk kanë rezultuar diferenca mes inventarit kontabël dhe inventarëve fizik, por konstatohet se në ambientet e Bashkisë dhe në institucionet varëse të saj ndodhen materiale të dëmtuara, amortizuara dhe jashtë përdorimi me vlerën totale 13,643,806 lekë. Këto materiale jashtë përdorimi kryesisht përbëhen nga: tavolina, karrige, kapëse aktesh, makina llogaritëse, kompjuterë, etj. Për këto materiale jashtë përdorimit nuk është vazhduar me tej procedura konform UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” për, tjetërsimin dhe ndarjen e tyre, në materiale që kanë vlerë përdorimi si, mbetje për dru zjarri që mund të përdoren për nevojë të vetë bashkisë, në materiale mbeturinë që kanë vlerë skrapë dhe mund të shiten, etj, dhe për mbetjet e tjera që janë pa vlerë përdorimi të ngrihen komisione të posaçme për asgjësimin e tyre (*vlera e materialet jashtë përdorimi të ndodhura në institucionet e bashkisë Pukë, paraqitet në aneksin nr.3, tabela nr.29 bashkëlidhur Projekt Raportit*).

Kriteri: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Impakti: Krijimi stoqeve të materialeve jashtë përdorimit.

Shkaku: Mos fillimi i procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit.

Rëndësia: I Mesëm

Rekomandimi: Bashkia Pukë, të ngrejë komisione të posaçme për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të mbajtura në ambientet e bashkisë dhe institucionet varëse të saj.

Për sa më sipër, përgjegjësia është e z. Gj. Gj, me funksion ish Kryetar i Bashkisë Pukë, znj. F. P, në funksionin e ish Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm.

II.2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta dhe të vogla, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve

Në zbatim të pikës 2.4 të Projekt Raportit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Regjistri i realizimit të prokurimeve të periudhës 01/01/2022 – 31/12/2022;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- 5- Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;
- 6- Urdhër pagesat e vlerës së kontratave të lidhura.

2.4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me Vendim të KB sipas viteve përkatëse bashkë me ndryshimet gjatë vitit.

2.4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-

së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

- Për periudhën **01.01.2022 – 31.12.2022**, Bashkia Pukë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **87** procedura prokurimi me fond limit **37,595,307 lekë pa TVSH**, me vlerë kontrate **29,926,764 lekë pa TVSH**, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **7,668,543 lekë pa TVSH**, ose 20.4%. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022	Nr.	Vl.Fond Limit	Vl.Kontrate
GJITHESEJ	87	37,595,307	29,926,764
- Të hapura	0		
- Kërkesë me propozim	0		
- Shërbim konsulence	0		
- Negocim pa shpallje	0		
- E hapur e thjeshtuar	3	8,294,889	8,060,801
- Vlerë e vogël	84	29,300,418	21,865,963
Sipas objekteve			
-Objekte në fushën e punëve publike	22	12,966,483	12,160,882
-Objekte në fushën e shërbimeve/blerje	65	24,628,824	17,765,882

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **1389 OE/BOE**, nga të cilat janë s’kualifikuar **467 OE/BOE** dhe OE të kualifikuar janë gjithsej **922**. Procedura me **1 (një) OE** është gjithësej 1 procedurë, ose 14 % e procedurave të zhvilluara.

2.4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

-Gjithësej 18 procedura me fond limit 18,521,268 lekë, ose 49% të totalit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit u konstatuan mangësi në procedurat si më poshtë vijon¹⁰:

Periudha 01.01.2022-31.12.2022

Prokurimet me vlerë të lartë

1. Tenderi me objekt: “Blerje Karburant për Bashkinë Pukë dhe institucionet në varësi”;
2. Tenderi me objekt: “Ndërtim Ura Kabash”
3. Tenderi me objekt: “Ndërtim Trotuari dhe ndriçimi rrugor në segmentin Rotondo - Gjykata Pukë”;

Prokurimet me vlerë të vogël

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kontenier për mbetjet urbane 2022”;
5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për ndërtimin e urës në fshatin Lum-Prift, segmenti Dedaj-Ukth, Njësia Administrative Qelez, Bashkia Pukë”.
6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Riparime Rruga Plet, Njësia Administrative Luf-Qerret”;

¹⁰ Ndikimi, kriteri, shkaku dhe rekomandimi janë dhënë në fund të trajtimit të procedurave të prokurimit në mënyrë të përmblodhur, me qëllim eliminimin e përsëritjes.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Sistemim sheshi, Guri i Shenjtë i Shën Palit dhe Riparimi i rrugës auto”;
8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i Qendrës së Zhvillimit të Start-Upeve, Bashkia Pukë”;
9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pelet për kaldaja”.
10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kripe dhe hedhjen në rrugët e territorit”.
11. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje paisje digjitale për Qendrën e Zhvillimit të Start-Up-eve”.
12. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje paisje ndriçues dhe shtylla ndricimi”.
13. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për kanal vaditës Rras-Kuzhnen ,Gjegjan”.
14. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rehabilitim i vend depozitimit të mbetjeve Gjegjan”.
15. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim Memorial Gjegjan”.
16. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim rezervuar uji në fshatin Midhe”.
17. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje automjet foristradë për shërbimet”.
18. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pllaka betoni për shtrim”.

1.Tenderi me objekt: “Blerje Karburant për Bashkinë Pukë dhe institucionet në varësi” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburant për Bashkinë Pukë dhe institucionet në varësi”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 131, Datë 12.05.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr.131,Nr.980 prot., dt.12.05.2022	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.132,Nr.980/1 dt.12.05.2022
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” Mallra	1. E. K (Jurist) 2. B. A (Inxh. Pyjesh) 3. E. P (Gjuhe të huaja)	1. K. M, Kryetar 2. E. P, Anëtar 3. A. Gj, Anëtar
5. Fondi Limit (pa TVSH) 4,177,250	6. Oferta fituese (pa TVSH) 3,997,295	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 179,955
8. Data e hapjes së tenderit 26.05.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkise dhe Granti	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 (dy) OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 980/12 Datë 29/06/2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 4,796,754 leke	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. PO
17- Situacioni Përfundimtar Ska	18. Afati i kontratës në ditë Parashikuar 12 muaj	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentimit dhe argumentimit të fondit limit, si dhe vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara plotësisht.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se përllogaritja e fondit limit nuk është argumentuar dhe dokumentuar plotësisht, si dhe në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar plotësisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i fondit limit dhe përcaktimi i kërkesave për karburant.

Fondi limit është përcaktuar nga njësia e prokurimit në mungesë të ngritjes së komisionit për përllogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike miratuar nga Kryetari i Bashkisë Pukë. -Fondi limit është përllogaritur në vlerën 4,177,250 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i

dokumentacioneve rezulton se nuk pasqyrohet përlllogaritja e fondit limit si dhe NJP nuk jep informacion se ku është referuar për çmimet e marra për referencë, se cilës bursë i janë referuar për të dhënat për përlllogaritjen e kryer. Nuk jep informacion nëse i referohet çmimeve të publikuara në buletin e APP. Veç sa më sipër, nuk dokumentohet se kujt subjekteve që tregëtojnë karburant i është drejtuar NJP me qëllim marrjen e ofertave prej tyre për të testuar tregun. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme nuk mbrojnë interesat ekonomike të AK, pasi mos dokumentimi konkret i mënyrës së përlllogaritjes së fondit limit, mund të mbivlerësojë fondin e për rrjedhojë rritë shpenzimet e institucionit për blerjen e karburantit.

-Sasia totale e nevojshme për konsum për vitin 2022 është bërë sipas preventivit të hartuar nga specialisti z. B. A dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, e ndarë sipas drejtorive dhe njësive administrative, përkatësisht: Ndërmarrja e Pastrimit, Drejtoria e Shërbimeve, Shërbimi Pyjor, Njësitë Administrative, për raste emergjente dhe Sektori i Zjarrëfikses.

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se mungojnë kërkesat për karburant nga secila drejtori/sector përkatës, ku në asnjë rast nuk pasqyrohen targat e automjeteve, për të përlligjur nevojën për karburant.

-Gjithashtu, nuk dokumentohet me program pune vjetor, ku përcaktohen punët që do të kryhen nga secila drejtori/sector, për të arritur në vlerësimin e sasisë së nevojshme për karburant.

-Në përfundim është caktuar vlera totale 4,177,250 lekë pa TVSH dhe 4,796,754 lekë me TVSH me marzh fitimi 11 lekë/litër.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, z. B. A, z. E. K dhe z. E. P, të cilët veç përlllogaritjes së fondit limit, duhet të kishin arsyetuar edhe kërkesën për sasinë e karburantit, ose në rast të kundërt nuk duhet të kishin pranuar kërkesat e bëra nga sektorët e mësipërm, me qëllim kthimin dhe plotësimin e tyre.

Hartimi i kriterëve nga NJP.

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit që prokurohet – Ndërkohë që sipas pikës 4 në nenin 40 dhe nenin 55 në pikën 4 shkronja “b” në VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, në rastet e prokurimeve për mallra vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet si dhe për kontratat e mallrave vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 20% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Në kriteret e mësipërme nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE pjesmarrës i cili duhet të jetë i pajisur me vërtetim të lëshuar nga ISHTI (Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial), që subjekti ofertues ka importuar ose tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar, dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë. - Ky kriter bazohet në nenin 36 dhe nenin 77, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 44, të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

-Në kriteret për kapacitetet teknik nuk është vendosur si kriter dorëzimi nga OE i protokoll-matjeve/verifikimi metrologjik për saktësinë e sasisë së hedhjes së karburantit për instrumentat matës (pistoletat e shpërndarjes së karburantit) detyrim ligjor për subjektet që përdorin instrumente matës¹¹ me qëllim mbrojtjen e interesave të AK në sasinë e karburantit në furnizimin pranë stacionit të shitjes.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është vendosur detyrimi që OE të jetë i pajisur me certifikatë elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim

¹¹ Neni 19 dhe 20 në Ligjin nr. 126/2020 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën kur janë hartuar dhe miratuar kriteret e veçanta të kualifikimit.

lëshimin e faturës elektronike¹².

-Sa më sipër kriteret e kualifikimit janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3, 4, gërma “c” në pikën 6 në nenin 40, nenin 44, dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, E. K, B. A dhe E. P.

Vlerësimi i ofertave

-KVO është ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë me Urdhër Nr. 132, nr.980/1 prot., datë 12.05.2022 dhe përbëhet nga z. K. M, Kryetar, z. E. P. dhe znj. A. Gj Anëtar.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE dhe janë kualifikuar; OE “K” Sh.pk, me marzh fitimi 14,9 lekë/litër dhe OE “E. D. A” Sh.a dhe është shpallur fituese OE “E. D. A” Sh.a, me marzh fitimi 11 lekë/litër.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, raporti përmbledhës, në përputhje me nenin 80 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

-Është shpallur fitues OE “E. D. A” shpk me marzh fitimi 11 lekë/litër. Nga auditimi i vlerësimit të ofertës së mësipërme, kualifikimi dhe shpallja fitues i OE “E. D. A” Sh.P.K qëndron.

2.Tenderi me objekt: “Ndërtim Ura Kabash” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim Ura Kabash”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 161 datë 07.06.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 161 dt.07.06.2022 1.E. K (Jurist) 2.A. M (Inxh. Ndërtimi) 3.A. L (Inxhnier)	4. Komisioni I Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 162 dt.07.06.2022 1.K. M (Kryetar) 2.E. P (Anëtar) 3.B. A (Anëtar)
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” Mallra		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 2,324,650	6. Oferta fituese (pa TVSH) “D-1” sh.p.k 2,308,898 Lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 15,752
8. Data e hapjes së tenderit 22.06.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Granti	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrësnë tender 1 (nje) OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatim i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 1154/12 Date 25/07/2022	15. Vlera e kontratës (me TVSH) 2,770,678 leke	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. Po
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 35 ditë	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të veçanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Mbi përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar nëpërmjet procesverbalit nr.1154/3 prot., datë 09.06.2022 të mbajtur nga NJP për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Pika 2.2.1 - Operatori Ekonomik duhet të paraqes kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet financiare (2019, 2020, 2021), ose vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës që po prokurohet – Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 4 në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

¹² Neni 48 në Ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.

regullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Konkretisht sipas referencës ligjore, përcaktohet se për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për më tepër që edhe në rekomandimin e APP nr. 3872, datë 10.06.2021 (bashkëlidhur procesverbali për argumentimin e kriterëve, sipas procedurës përkatëse) ka një shënim për kriterin e mësipërm: “Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të **argumentojnë** vlerën e kërkuar të xhiros **brenda** këtij marzhi”, pra VKM përcakton kufirin maksimal, nga 0-40%, ndërkohë proceverbali tip, e përcakton qartë, zgjidh një marzh brenda këtij intervali, si p.sh jo më pak se 30% e fondit limit dhe ky marzh duhet argumentuar. Sjellim në vëmendje këtu edhe rekomandimin e APP me shkresën nr.7998 prot., datë 24.12.2021, pika 8, paragrafi 3.

Në pikën 2.3.3 kërkohej që OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Janar-Maj 2022. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit - Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 10 të punësuar, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohej “Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve.

Nuk argumentohet periudha e vendosur Janar-Maj 2022 (5 muaj) për disponimin e numrit mesatar të punonjësve, pra si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për AK, sa i përket përmbushjes së kapaciteteve teknike, është e rëndësishme që në momentin kur OE merr pjesë në procedurë, të ketë numrin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

Në pikën 2.3.5 kërkohej që OE duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e mëposhtme:

Autobot uji	1 copë	Pronesi ose me qera
Sonde shpimi Ø800mm	1 copë	Pronesi ose me qera
Betonjere 500 liter	1 cope	Pronesi ose me qera
Vibrator thellesie	2 cope	Pronesi ose me qera
Vinc Kulle	1 cope	Pronesi ose me qera
Ekskavator 0.25 m3	1 cope	Pronesi ose me qera
Rul me vibrim	1 cope	Pronesi ose me qera

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, numri dhe lloji i mjeteve që kërkohej, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i shoferëve dhe i manovratorëve. Mungesa e shoferëve dhe e manovratorëve sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe realizimin e punimeve.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është vendosur detyrimi që OE të jetë i pajisur me certifikatë elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim lëshimin e faturës elektronike¹³.

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi NJP me përbërje si vijon, E. K, A. M dhe A. L.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër Nr. 162 datë 07.06.2022 të Kryetarit të Bashkisë Pukë dhe

¹³ Neni 48 në Ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.

përbëhet nga z. K. M, Kryetar, z. E. P dhe z. B. A Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës.

Në këtë tender ka marrë pjesë OE përkatësisht:

OE “D-1” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 2,308,898 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 15,752 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁴, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

- OE “D-1” Shpk, nuk plotëson **pikën 2.3** të kapacitetit Teknik në DST, për punë të ngjashme ka paraqitur:

a. Kontratën me nr. 2965 prot., datë 23.09.2019, me objekt “Rikonstruksion i kanalit ujitës lagja Fushaxhi”, vlera e kontratës 3,305,788 lekë pa TVSH;

b. Kontratën (pa nr. prot.) datë 25.01.2016, me objekt “Mirëmbajtje rutinë dimërore Rruga Laç-Vau Dejës Fushë Arrëz 60.1 km”, Vlera e kontratës 49,827,600 lekë pa TVSH;

c. Kontratën (pa nr. prot., pa datë, pa firmë nga titullari i Bashkisë Fusharrëz), me objekt “Ndërtim i bazamenteve të urave lagja Koprat, fshati Iballë dhe Micoj”, Vlera e kontratës 552,000 lekë pa TVSH;

- Nuk plotësohet **pika 2.3.3 e DST**, për punonjësit e kërkuar të cilët duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë (vërtetim nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj) për periudhën e kërkuar Janar – Maj 2022”, nga OE nuk është dorëzuar Listëpagesa e shoqërisë, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e kërkuar në DST;

- Nuk plotësohet **pika 2.3.5**, pasi në dokumentacionin e dorëzuar nga OE “D-1” Shpk, nuk është dorëzuar dokumentacioni për Vinç Kullë të kërkuar në DST si dhe nuk është deklaruar as tek vetëdeklarimi shtojca 8.

- Nuk plotësohet **pika 2.3.5**, pasi në DST është kërkuar Betoniere 500 litër dhe jo Autobetoniere;

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. K. M, Kryetar, z. E. P dhe z. B. A Anëtar.

3.Tenderi me objekt: “Ndërtim Trotuari dhe ndriçimi rrugor në segmentin Rotondo - Gjykata Pukë” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim Trotuari dhe ndriçimi rrugor në segmentin Rotondo - Gjykata Pukë”		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 218 , datë 03.08.2022	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 218 datë 03.08.2022 1.E. K (Jurist) 2.A. M (Inxh. Ndërtimi) 3.A. L (Hartograf)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 219 datë 03.08.2022 1.K. M, Kryetar 2.E. P, Anëtar 3.B. A, Anëtar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar” Pune		
5. Fondi Limit (pa TVSH) 1,792,989	6. Ofertafituese (pa TVSH) “D-1” sh.p.k 1,754,607	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 38,382
8. Data e hapjes së tenderit 22.08.2022	9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe Granti	10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrësnë tender 2 (dy) OE ska paraqitur formular oferte b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka.	12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP S’ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr.1300/21 Datë 06/10/2022	15. Vlera e 2,105,528 leke me tvsh kontratës (me TVSH)	16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. Po
17- Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në ditë 21 dite	19. Zgjatja e kontratës me - ditë -

¹⁴ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Sa më sipër u konstatua:

Titulli i gjetjes: Vendosja e kriterëve të vecanta të kualifikimit jo të argumentuara, si dhe shpallja fituese e ofertës në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit, u konstatua se në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim. Gjithashtu është shpallur fituese oferta ekonomike në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit. Konkretisht si më poshtë vijon:

Hartimi i kriterëve dokumentuar me procesverbalin nr.1300/12 prot., datë 04.08.2022 nga NJP për argumentimin e kriterëve të vecanta të kualifikimit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Në pikën 2.2.1 nga AK kërkohet që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. – Sipas përcaktimit në shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kapaciteti teknik

Në pikën 2.3.3 kërkohet që OE, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 10 (dhjetë) punonjës, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin Janar-Qershor 2022. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit - Në kërkesën e mësipërme nuk përcaktohet lloji i formimit profesional për punonjësit e kërkuar, pasi OE mund të ketë 10 të punësuar, ndërkohë këta punonjës nuk duhen për zbatimin e kontratës përkatëse, ç’ka e bën një kriter jo konkret dhe jo në përputhje me qëllimin që kërkohet “*Kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektin*”.

-Për numrin e mësipërm të punonjësve, në procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të kriterëve, nuk pasqyrohet analiza teknike, e cila shërben për vlerësimin e numrit minimal të punonjësve.

Nuk argumentohet periudha e vendosur Janar-Qershor 2022 (6 muaj) për disponimin e numrit mesatar të punonjësve, pra si ndikon kjo në përmbushjen e kapaciteteve teknike. Për AK, sa i përket përmbushjes së kapaciteteve teknike, është e rëndësishme që në momentin kur OE merrë pjesë në procedurë, të ketë numrin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Vendosja e periudhës së mësipërme tregon më tepër qëndrueshmëri financiare, por jo përmbushjen e kapaciteteve teknike.

Në pikën 2.3.5 kërkohet që OE duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e mëposhtme:

Emërtimi	Njësia	Sasia
Ekskavator 0.25 m3	copë	1
Rul me vibrim	copë	1
Autobot uji	copë	1
Betonjere 500 liter	copë	1
Vibrator thellesie	copë	1
Auto Vinç 5 T	copë	1
Saldatriçe elektrike	copë	1
Trapano elektrike	copë	1
Kamion deri në 10 ton	copë	1

Në procesverbalin përkatës nuk argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, numri dhe lloji i mjeteve që kërkohet, në përputhje me punën që do të kryejnë, volumin dhe grafikun e punimeve.

Veç sa më sipër janë kërkuar makineri ndërtimi, por në asnjë rast nuk është kërkuar edhe disponimi i shoferëve dhe i manovratorëve. Mungesa e shoferëve dhe e manovratorëve sjellë pamundësinë e përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe realizimin e punimeve.

-Në kriteret e vecanta të kualifikimit nuk është vendosur detyrimi që OE të jetë i pajisur me

certifikatë elektronike nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, me qëllim lëshimin e faturës elektronike¹⁵.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43 pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika 2.3.6 - Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

ISO 9001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të cilësisë/ ekuivalente dhe e vlefshme.

ISO 14001:2015 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të ambientit/ ekuivalente dhe e vlefshme

ISO 45001:2018 - Certifikatë për sistemimin e menaxhimit të sigurisë në punë/ ekuivalente dhe e vlefshme

Këto kërkesa për certifikata nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës.

Përsa më sipër sipas rolit të tyre në NJP, mban përgjegjësi z. E. K, z. A. M dhe z. A. L.

Vlerësimi i ofertave.

KVO është ngritur me urdhër Nr. 1300/100 datë 03.08.2022 të Kryetarit të Bashkisë Pukë dhe përbëhet nga z. K. M, Kryetar, z. E. P dhe z. B. A, Anëtar.

-Janë mbajtur procesverbalet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave si dhe raporti përmbledhës.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE përkatësisht:

OE “D. I” Sh.P.K, i cili nuk ka paraqitur ofertë për këtë procedurë prokurimi.

OE “D-1” Sh.P.K, me ofertën ekonomike në shumën 1,754,607 lekë pa TVSH, me diferencë nga fondi limit, gjithësej 38,382 lekë.

Është s’kualifikuar OE “D. I” Sh.P.K.

OE i skualifikuar:

➤ “D. I” Sh.P.K, është s’kualifikuar me arsyet e mëposhtme:

1.Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike.

-S’kualifikimi i OE të mësipërm qëndron.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁶, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk plotësohet **pika 2.3.3 e DST**, për punonjësit e kërkuar të cilët duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë (vërtetim nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj) për periudhën e kërkuar Janar – Qershor 2022”, nga OE nuk është dorëzuar Listëpagesa e shoqërisë, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e kërkuar në DST;

-Nga OE D-1, nuk është plotësuar **pika 2.3.5 e DST**, referuar shtojcës 8 të vetëdeklarimit, mjeti Autobot uji me targë AA...JF, nuk administrohet dokumentacioni i kërkuar në DST për disponimin e këtij mjeti;

-Nuk plotësohet pika 2.3.5 e DST për mjetin “Kamion me kapacitet mbartës deri në 10 ton”, pasi kapaciteti i mjetit është 16 ton, pra e ka tejkaluar kapacitetin e kërkuar në DST;

-Nuk plotësohet pika 2.3.5, pasi në DST është kërkuar Betoniere 500 litër dhe jo Autobetoniere;

-Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje si vijon, z. K. M, Kryetar, z. E. P dhe z. B. A, Anëtar.

Kriteri: Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”;

¹⁵ Neni 48 në Ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar.

¹⁶ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Uljen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe të kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Titulli i Gjetjes: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla).

Situata: Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatua si më poshtë:

- Në 15 raste nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlogaritur fondin limit, si dhe nuk dokumentohet përlogaritja e fondit limit;
- Në 15 raste nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Në 6 rast rezulton se OE të shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- Në 15 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Në 12 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla si dhe nuk janë përlogaritur penaltitetet;
- Në 15 raste nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

Kriteri: Neni 76 i Ligjit 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Pika 2 në nenin 26, neni 27, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 1 në nenin 79 në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 17 në Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”; Pika 5 në Udhëzimin nr.8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”; Udhëzimi i MFE nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbtimit të buxhetit” i ndryshuar; Neni 32 në Ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Ndikim negativ në transparencën dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për prokurimin me vlerë të vogël.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa që për 12 rastet e konstatuara ku

nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlogariten penalitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Më hollësisht rastet trajtuar si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **“Blerje kontenier për mbetjet urbane 2022”**.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 93, me nr. 11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, z. K. M, znj. E. P;

-Urdhri nr. 190, me nr. 957/5 prot., datë 04.07.2022, i prokurimit për blerje kontenier për mbetjet urbane.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 833,333 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 22.08.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 957/6 prot., datë 04.07.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 11/2022, datë 22.08.2022, në vlerën e 960,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, z. K. M, znj. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “B” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 616,600 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 06.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 13.07.2022 OE “B” shpk, nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka bërë kërkesë tërheqje;

AK ka vazhduar me OE “E Z” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 659,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 14.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 14.07.2022 OE “E Z” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “E Z” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “Q D” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 659,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 15.07.2022, nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 15.07.2022 OE “Q D” Shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “Q D” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit;

AK ka vazhduar me OE “3 E C” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 660,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 19.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 19.07.2022 OE “3 E C” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka bërë kërkesë tërheqje;

AK ka vazhduar me OE “S Rr” Shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 750,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 21.07.2022 OE “S Rr” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “HB-G” Shpk, ka deklaruar se tërhiqet nga gara, nuk administrohet në dosjen fizike dhe në sistemin e prokurimit.

AK ka vazhduar me OE “J” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 800,000 lekë pa

Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 33,333 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 21.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Pukë përfaqësuar nga Kryetari Gj. Gj dhe Operatorit Ekonomik “J” Shpk është lidhur Kontratë për mallra me nr. 957/9 prot., datë 22.07.2022 për “Blerje kontenier për mbetjet sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Pukë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 5 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate;

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softwer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “J” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

-Nuk administrohet deklaratë garancie për mallin e prokuruar;

-Afati i lëvrimin të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 5 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues ka lidhur kontratën me Bashkinë Pukë më datë 22.07.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 29.07.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 22.08.2022, pra 22 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P.

2. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për ndërtimin e urës në fshatin Lum-Prift, segmenti Dedaj-Ukth, Njësia Administrative Qelez, Bashkia Pukë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 273, me nr. 11/2 prot., datë 04.10.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, znj. A. D, znj. E. P;

-Urdhri nr. 314, me nr. 1493/22 prot., datë 15.11.2022, i prokurimit për blerje materiale për ndërtimin e urës në fshatin Lum-Prift, segmenti Dedaj-Ukth, Njësia Administrative Qelez, Bashkia Pukë.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 711,059 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 12.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1493/23 prot., datë 15.11.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.26/2022, datë 12.12.2022, në vlerën e

851,760 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, znj. A. D dhe znj. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “EKM K & T” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 699,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 16.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 17.11.2022 OE “EKM K & T” shpk, është tërhequr nga gara nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit të pasqyryar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “EKM K & T” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara për arsye të një gabimi në përlogaritje të preventivit, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “B” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 699,900 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 17.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 22.11.2022 OE “B” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “B” Shpk;

AK ka vazhduar me OE “J” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 709,800 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 1,259 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 22.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Pukë përfaqësuar nga Kryetari Gj. Gj dhe Operatorit Ekonomik “J” Shpk është lidhur Kontratë për mallra me nr. 1493/26 prot., datë 22.11.2022 për “Blerje materiale për ndërtimin e urës në fshatin Lum-Prift, segmenti Dedaj-Ukth, Njësia Administrative Qelez, Bashkia Pukë, sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Pukë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 2 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përlogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “J” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

-Nuk administrohet deklaratë garancie për mallin e prokuruar;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 2 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues e ka lidhur kontratën me Bashkinë Pukë më datë 22.11.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 24.11.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 12.12.2022, pra 18 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, znj. A. D dhe znj. E. P.

3. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: **“Riparime Rruga Plet, Njësia Administrative Luf-Qerret”.**

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 93, me nr. 11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit me përbërje, z. E. K, z. K. M, znj. E. P;

-Urdhri nr. 159, me nr. 1133 prot., datë 02.06.2022, i prokurimit për riparime rruga Plet, Njësia Administrative Luf-Qerret.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 662,848 lekë pa Tvsh;

-Urdhri i brendshëm nr.2, datë 21.06.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. M. P, z. K. B dhe z. P. F;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 30.06.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1133/1 prot., datë 02.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.6/2022, datë 23.06.2022, në vlerën e 701,484 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 584,570 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 78,278 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 03.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Pukë përfaqësuar nga Kryetari Gj. Gj dhe Operatorit Ekonomik “A” Shpk është lidhur Kontratë për shërbime me nr. 1133/4 prot., datë 06.06.2022 për “Riparime Rruga Plet, Njësia Administrative Luf-Qerret, sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Pukë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 15 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “A” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 15 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur ka lidhur kontratën me Bashkinë Pukë më datë 06.06.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 21.06.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 30.06.2022, pra 9 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P.

4. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Sistemim sheshi, Guri i Shenjtë i Shën Palit dhe Riparimi i rrugës auto”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 93, me nr. 11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, z. K. M, znj. E. P;

-Urdhri nr. 160, me nr. 1134 prot., datë 02.06.2022, i prokurimit për Sistemimin e sheshit, Guri i Shenjtë i Shën Palit dhe Riparimi i rrugës auto.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 500,000 lekë pa Tvsh;

- Nuk administrohet urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 19.07.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1134/1 prot., datë 02.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.85/2022, datë 19.07.2022, në vlerën e 597,600 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 338,484 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 03.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 08.06.2022 OE “A” shpk, nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “A” Shpk;

AK ka vazhduar me OE “S. Rr” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 465,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 09.06.2022 OE “S. Rr” Shpk është tërhequr nga gara nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit të pasqyryar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “S. Rr” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “EKM K & T” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 478,800 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 10.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 10.06.2022 OE “EKM K & T” Shpk është tërhequr nga gara nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit të pasqyryar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “EKM K & T” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “A. B” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 488,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 15.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 15.06.2022 OE “A. B” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “A. B” Shpk;

AK ka vazhduar me OE “E - 2000” Shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 490,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 20.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 20.06.2022 OE “E-2000” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “E-2000” Shpk;

AK ka vazhduar me OE “D – S K” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 494,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 23.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 23.06.2022 OE “D – S K” Shpk nuk është paraqitur pranë AK si dhe nuk ka dërguar njoftim tërheqje, për këtë arsye komisioni ka vendosur ta s’kualifikojë OE “Diar – S K” Shpk;

AK ka vazhduar me OE “4 A C” Shpk i renditur në vendin e shtatë me ofertën 498,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 24.06.2022 OE “4 A C” Shpk është tërhequr nga gara nëpërmjet njoftimit dërguar AK. Sipas informacionit të pasqyryar në dokumentet e vlerësimit të ofertave OE “4 A C” Shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, por që nuk administrohet në dosjen fizike;

AK ka vazhduar me OE “A 2018” i renditur **në vendin e tetë me ofertën 498,000 lekë pa TVSH**. Diferenca me fondin limit është 2,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 24.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

-Midis Bashkisë Pukë përfaqësuar nga Kryetari Gj. Gj dhe Operatorit Ekonomik “A 2018” Shpk është lidhur Kontratë për shërbime me nr. 1134/4 prot., datë 27.06.2022 për “Sistemim sheshi, guri i Shën Palit dhe riparim i rrugës egzistuese, sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Pukë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 9 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore të OE shpallur fitues;
- AK në ftesën për ofertë ka kërkuar mjete, si eskavator me zinxhir, rul ngjeshës dhe kamion por në asnjë rast nuk ka kërkuar shofer dhe manovrator për lëvizjen e mjeteve.
- Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përlogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;
- Nuk administrohet urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të punimeve;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- OE “A 2018” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:
- Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;
- Në pikën 5, në ftesën për ofertë është kërkuar që OE, për kryerjen e punimeve sipas preventivit duhe të ketë:
- Eskavator me zinxhir;
- Rul ngjeshës;
- Betoniere;
- Kamion me kapacitet Min. 2 Ton

Me të gjithë dokumentacionin tekniko ligjor për mjetet me goma si dhe siguracion, leje qarkullimi, taksa, akt-kualidim të vlefshëm – OE i shpallur fitues ka dorëzuar një akt marrëveshje me OE E Shpk, për zbatimin e kësaj kontrate, i cili vë në dispozicion mjetet për kryerjen e punimeve sipas preventivit.

- AK ka kërkuar Eskavator me zinxhir ndërkohe OE ka dorëzuar Eskavator me goma;
- Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 9 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues ka lidhur kontratën me Bashkinë Pukë më datë

27.06.2022, pra lëvrimit i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 06.07.2021, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar/marrë në dorëzim nga AK më datë 19.07.2022, pra 13 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për

dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P.

5. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rikonstruksion i Qendrës së Zhvillimit të Start-Upeve, Bashkia Pukë”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr. 93, me nr. 11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, z. K. M, znj. E. P;

-Urdhri nr. 227, me nr. 1582 prot., datë 23.08.2022, i prokurimit për rikonstruksionin e qendrës së zhvillimit të start-upeve.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 802,128 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.316, me nr.1583/7 prot., datë 16.11.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: znj. E. Gj, z. P. K dhe z. A. L;

-Procesverbali me nr. 1583/8 prot., datë 21.11.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 1582/1 prot., datë 31.08.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr. 60/2022, datë 18.11.2022, në vlerën e 768,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “K 04” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 640,000 lekë pa Tvsh. Diferenca me fondin limit është 2,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 02.09.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit;

-Midis Bashkisë Pukë përfaqësuar nga Kryetari Gj. Gj dhe Operatorit Ekonomik “K 04” Shpk është lidhur Kontratë për shërbime me nr. 1583/4 prot., datë 06.09.2022 për “Rikonstruksion i Qendrës së Zhvillimit të Start-Upeve”, sipas preventivit të paraqitur nga Bashkia Pukë dhe ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Sipas nënshkrimit të kontratës së mësipërme, data e përfundimit të shërbimit duhet të realizohet brenda 30 ditëve nga lidhja e kësaj kontrate.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjëndjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e inxhinierit për të përllogaritur fondin limit, pra inxhinieri nuk ka qenë i autorizuar për të kryer veprimin e mësipërm;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “K .” Shpk i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Nuk administrohet deklaratë nga operatori ekonomik shpallur fitues për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas ftesës për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori

ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 30 ditëve, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. OE shpallur fitues e ka lidhur kontratën me Bashkinë Pukë më datë 06.09.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 06.10.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 21.11.2022, pra 46 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, z. K. M dhe znj. E. P.

6. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pelet për kaldaja”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.273, me nr.11/2 prot., datë 04.10.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr. 321, me nr.1946/5 prot., datë 22.11.2022, i prokurimit për “blerje pelet për kaldaja”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 686,375 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E Gj dhe z. B. Z.;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 06.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 146/6 prot., datë 23.11.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.758/2022, datë 21.06.2022, në vlerën e 784,890 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare z. E. P, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “A. K”, me ofertën më të ulët, në vlerën 649,540 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 25.11.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 25.11.2022 OE “A. K” është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “A. K” ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “S. T” i renditur në vendin e dytë me ofertën 654,075 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit 32,300 lekë.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-OE “S. T” i shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK si më poshtë:

-Dokumenti i cili vërteton pagesën e detyrimeve vendore lëshuar nga Bashkia Lushnje është

i datës 27.04.2022.

-Nuk administrohen specifikimet teknike nga operatori ekonomik sipas ftesës për ofertë;
Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare.

7. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje kripe dhe hedhjen në rrugët e territorit”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.273, me nr.11/2 prot., datë 04.10.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr. 305, nr.2031 prot., datë 04.11.2022, i prokurimit për blerje kripe dhe hedhjen në rrugët e territorit.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 637,500 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A znj. E. Gj z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 29.12.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr. 2031/1 prot., datë 30.11.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.736/2022, datë 29.12.2022, në vlerën e 702.000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtar ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “2-M.” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 460,000 lekë pa Tvsh.

OE fitues është njoftuar në datë 01.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Pas njoftimit të OE shpallur fitues, rezulton se në datë 01.12.2022 OE “2-M.” shpk është tërhequr nga gara, nëpërmjet njoftimit dërguar AK; Sipas informacionit të pasqyruar në dokumentet e vlerësimit të ofertave, OE “2-M.” shpk ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “HB-G” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 576,000 lekë pa TVSH.

OE Fitues është njoftuar në datë 02.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Më datën 09.12.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE -G” Shpk i renditur në vendin e dytë nuk ka dorëzuar mallin sipas afateve të parashikuara në ftesën për ofertë.

Me procesverbalin nr.3, datë 12.12.2022 AK ka vazhduar me OE “J X.XL” shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 585,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 52,500 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.12.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përllogaritur fondin limit;

-Nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit.

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare.

8. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje paisje digjitale për Qendrën e Zhvillimit të Start-Up-eve”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.273, me nr.11/2 prot., datë 04.10.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr. 282, nr.1898 prot., datë 13.10.2022, i prokurimit për blerje paisje digjitale për Qendrën e Zhvillimit të Start-Up-eve.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 918,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 02.11.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofert me nr.1898/1 prot., datë 13.10.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.46/2022, datë 02.11.2022, në vlerën e 948,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “L S” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 510,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 19.10.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Më datën 27.10.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “L S” Shpk i renditur në vendin e parë nuk ka sjell mallin sipas kushteve teknike dhe afateve të parashikuara në ftesën për ofertë, malli është kthyer nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe nuk është risjell përsëri, në këto kushte nga AK është njoftuar OE “N” i renditur në vendin e dytë me ofertën 790,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 32,000 lekë pa Tvsh OE Fitues është njoftuar në datë 31.10.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, znj. A. D, Anëtare znj. E. P, Anëtare.

9. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje paisje ndriçues dhe shtylla ndricimi”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr. 229, nr.1584 prot., datë 23.08.2022, i prokurimit për “Blerje paisje ndriçues dhe shtylla ndricimi”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 666,667 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 21.09.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1584/1 prot., datë 21.09.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.229/2022, datë 23.11.2022, në vlerën e 948,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: E. K, Kryetar, z.K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “K” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 500,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 29.08.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Më datën 30.08.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “K” Shpk i renditur në vendin e parë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “E” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 645,210 lekë pa TVSH, Më datën 06.09.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE - “E” Shpk i renditur në vendin e dytë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “L.VII” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 647,890 lekë pa TVSH, Më datën 08.09.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “L. VII” Shpk i renditur në vendin e tretë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “J & SH” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 649,900 lekë pa TVSH. Më datën 09.09.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “J & SH” Shpk i renditur në vendin e katërt ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “P M” Shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 652,000 lekë pa TVSH, Më datën 09.09.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “P M” Shpk i renditur në vendin e pestë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “X S” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 655,000 lekë pa TVSH. Më datën 12.09.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “X S” Shpk i renditur në vendin e gjashtë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “J” Shpk i renditur në vendin e shtatë me ofertën 662,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 4,667 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 13.09.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlogaritur fondin limit;
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

- Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
- Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 2 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 14.09.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 16.09.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 21.09.2022, pra 5 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z.

10. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale për kanal vaditës Rras-Kuzhnen, Gjegjan”.

Përshkrimi i veprimeve;

- Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtarë;
- Urdhri nr.145, me nr.102/1 prot., datë 18.05.2022, i prokurimit për “Blerje materiale për kanal vaditës Rras-Kuzhnen, Gjegjan”.
- Fondi limit është përcaktuar në vlerën 419,500 lekë pa Tvsh;
- Urdhri nr.1, me nr.221 prot., datë 07.06.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. P. P znj. A. N dhe z. A. Gj;
- Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 14.06.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;
- Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1024/1 prot., datë 18.05.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.
- Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.19/2022, datë 08.06.2022, në vlerën e 489,000 lekë me Tvsh;
- Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “R.N.M” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 407,500 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 19.05.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Diferenca me fondin limit është 12,000 lekë pa Tvsh

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlogaritja e fondit limit.
- Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;
- Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;
- Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

- Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlogaritur fondin limit;
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të

vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;
-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 2 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 24.05.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 26.05.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 14.06.2022, pra 19 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. P.P, znj. A. N dhe z. A. Gj;

11. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Rehabilitim i vend depozitimit të mbetjeve Gjegjan”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr.186, me nr.1285 prot., datë 27.06.2022, i prokurimit për “Rehabilitim i vend depozitimit të mbetjeve Gjegjan”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 499,050 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.232, me nr.1285/6 prot., datë 24.08.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. A. Me, z. B. A dhe z. A. H;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 14.06.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1275/1 prot., datë 27.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.11/2022, datë 23.08.2022, në vlerën 588,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “D - 1” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 490,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 29.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 9,050 lekë pa Tvsh.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softwer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 24.05.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 04.06.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 25.08.2022, pra 45 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. A. M, z. B A dhe z. A. H;

12. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim Memorial Gjegjan”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare;

-Urdhri nr.175, me nr.1263 prot., datë 24.06.2022, i prokurimit për “Ndërtim Memorial Gjegjan”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 458,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. A. M, z. B. A dhe znj. A. M;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 25.08.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1263/1 prot., datë 24.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.766/2022, datë 20.07.2022, në vlerën e 480,000 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “S. R” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 400,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 27.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 58.000 lekë pa Tvsh.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklarata e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softwer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 28.06.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 07.07.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 25.08.2022, pra 49 ditë vonesë. Në kushtet kur nga

OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje, z. A. M, z. B. A dhe znj. A. M;

13. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Ndërtim rezervuar uji në fshatin Midhe”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtarë;

-Urdhri nr.237, me nr.1620 prot., datë 31.08.2022, i prokurimit për “Ndërtim rezervuar uji në fshatin Midhe”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 451,919 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.08, me nr.211 prot., datë 06.10.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. F. M, znj. S. M dhe znj. R. M;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 06.10.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1620/1 prot., datë 31.08.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.80/2022, datë 11.10.2022, në vlerën e 502,560 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “B” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 418,800 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 27.06.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 33,119 lekë pa Tvsh.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e certifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përlllogaritur fondin limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 20 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 07.09.2022, pra lëvrimit i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 27.09.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 06.10.2022, pra 9 ditë vonesë.Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s’kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K,

Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. F. M, znj. S. M dhe znj. R. M;

14. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje automjet foristradë për shërbimet”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.4, me nr.11 prot., datë 07.01.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar z. I. T, Anëtar;

-Urdhri nr.32, nr.213 prot., datë 08.02.2022, i prokurimit për “Blerje automjet foristradë për shërbimet”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 1,000,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.61, me nr.213/6 prot., datë 09.03.2022 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. A. M, z.A. H dhe z. S. F;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 09.03.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.213/1 prot., datë 08.02.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.6/2022, datë 04.03.2022, në vlerën e 1,150,800 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar z. I. T, Anëtarë, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “N” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 842,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 09.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Më datën 16.02.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “N” Shpk i renditur në vendin e parë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “M. M” Shpk i renditur në vendin e dytë me ofertën 888,000 lekë pa TVSH, më datën 17.02.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “M. M” Shpk i renditur në vendin e dytë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “S” Shpk i renditur në vendin e tretë me ofertën 890,000 lekë pa TVSH, Më datën 18.02.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “S” Shpk i renditur në vendin e tretë ka deklaruar se tërhiqet nga gara, bashkëlidhur kërkesa e tërheqjes;

AK ka vazhduar me OE “V O” Shpk i renditur në vendin e katërt me ofertën 919,000 lekë pa TVSH, Më datën 22.02.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “V O” Shpk i renditur në vendin e katërt nuk është paraqitur sipas afateve në ftesën për ofertë;

AK ka vazhduar me OE “P J P” Shpk i renditur në vendin e pestë me ofertën 939,000 lekë pa TVSH, Më datën 24.02.2022 është mbajtur procesverbali për kalimin tek OE i radhës pasi OE “P M” Shpk i renditur në vendin e pestë nuk është paraqitur sipas afateve në ftesën për ofertë;

AK ka vazhduar me OE “O M” Shpk i renditur në vendin e gjashtë me ofertën 959,000 lekë pa TVSH. Diferenca me fondin limit është 41,000 lekë pa Tvsh.

OE Fitues është njoftuar në datë 25.02.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përlllogaritja e fondit limit.

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykate të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së

lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përllogaritur fondin limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

Nuk është plotësuar specifikimi teknik ku përcaktohet se kilometrazhi i mjetit nuk duhet të jetë më shumë se 200.000 km, ndërkohë sipas certifikatës së kontrollit teknik të mjeteve rrugore bashkëlidhur konstatohet se mjeti ka 206.000 km.

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 5 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 25.02.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 02.03.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 09.03.2022, pra 7 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtare si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. A. M, z. A. H dhe z. S. F.

15. Procedura e prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje pllaka betoni për shtrim”.

Përshkrimi i veprimeve;

-Urdhri nr.93, me nr.11/1 prot., datë 04.04.2022, për ngritjen e komisionit të prokurimit, me përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtarë;

-Urdhri nr.185, datë 27.06.2022, i prokurimit për “Blerje pllaka betoni për shtrim”.

-Fondi limit është përcaktuar në vlerën 980,000 lekë pa Tvsh;

-Urdhri nr.181, me nr.1468 prot., datë 15.08.2018 për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z;

-Procesverbali (pa nr. prot.,) datë 26.07.2022 i marrjes në dorëzim të mallrave;

-Në dosje administrohet ftesa për ofertë me nr.1284/1 prot., datë 27.06.2022, me specifikimet bashkëlidhur, si dhe përcaktohet që OE i renditur në vendin e parë të dorëzoj dokumentacionin pranë AK përpara se të bëhet shpallja e fituesit.

-Likuidimi i OE është bërë sipas faturës tatimore me nr.32/2022, datë 26.07.2022, në vlerën e 1,151,992 lekë me Tvsh;

-Vlerësimi i ofertave është realizuar nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël me përbërje: z. E. K, Kryetar, z. K. M, Anëtar znj. E. P, Anëtarë, ku është shpallur fitues operatori i renditur në vendin e parë OE “O M” Shpk me ofertën më të ulët, në vlerën 960,000 lekë pa Tvsh. OE Fitues është njoftuar në datë 19.07.2022 nëpërmjet sistemit të prokurimit. Diferenca me fondin limit është 20,000 lekë pa Tvsh.

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kryer nga specialisti i fushës përllogaritja e fondit limit.

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është në proces falimentimi;

-Nuk është kërkuar vërtetim se subjekti nuk është i dënuar me vendim Gjykatë të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional;

-Nuk është kërkuar kopje e certifikatës elektronike për fiskalizim dhe kopje të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen e softëer-ike;

Nga auditim i dokumentacionit të hartuar dhe miratuar nga AK, u konstatua se:

-Nuk administrohet urdhri i titullarit për ngritjen e komisionit për të përllogaritur fondin

limit;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Nga auditim i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, pasi në ftesën për ofertë është përcaktuar të bëhet brenda 20 ditëve nga data e lidhjes së kontratës, kontrata është lidhur në datën 07.09.2022, pra lëvrimi i mallit/realizimit të shërbimit/punës duhej të realizohej brenda datës 27.09.2022, ndërkohë malli dhe shërbimi/punës është realizuar më datë 06.10.2022, pra 9 ditë vonesë. Në kushtet kur nga OE shpallur fitues nuk janë respektuar kriteret e vendosura nga AK, komisioni i prokurimit duhej të mbante procesverbalin për dokumentimin e situatës, si dhe të bënte s'kualifikimin e tij dhe vazhdimin me OE e radhës.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje, z. E. K, Kryetar, z. K. M dhe znj. E. P, Anëtarë si dhe komisioni për marrjen në dorëzim, me përbërje: z. B. A, znj. E. Gj dhe z. B. Z.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, detyrat e përcaktuara për rolin e titullarit, NJP dhe KVO në administrimin e procedurave të prokurimit publik deri në lidhjen e kontratës me OE të shpallur fitues, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:

z. Gj. Gj, ish Kryetari i Bashkisë Pukë, në rolin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, z. E. K, Përgjegjës i sektorit të Prokurimeve Publike dhe Juridik, z. B. A, Përgjegjës Sektori i Emergjencave dhe Shërbimeve, znj. E. P, ish Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, znj. A. D, Specialiste Finance, z. K. M, Specialist Finance, znj. E. Gj, zv. Kryetare e Bashkisë, z. A. M, Drejtor i Shërbimeve Komunitare, z. B. Z, Punonjës Shërbimesh, znj. S. M, Specialiste Finance, z. A. Gj, z. S. F, z. P. P, znj. A. N, z. A. Gj, z. A. H, z. F. M, znj. R. M, znj. A. M punonjës administrate.

2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomik fitues.

Shënim: Në lidhje me auditimin mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, për periudhën objekt auditimi, nuk u krye auditim për arsye objektive, sqarojmë se kjo çështje do të auditohet në një periudhë tjetër, në auditimet në vijim.

III.2.5. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Shënim: Në lidhje me auditimin mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit, për periudhën objekt auditimi, nuk u krye auditim për arsye objektive, sqarojmë se kjo çështje do të auditohet në një periudhë tjetër, në auditimet në vijim.

III.2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. (IVMT).

2.6.1. Mbi zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit, grupi i auditimit, për periudhën objekt auditimi 01.01.2022 – 31.12.2022, kërkoi vënien në dispozicion të dokumenteve të nevojshme siç janë, struktura e IVMT dhe formimi profesional i stafit të kësaj strukture, dosjet e procedurave të mbajtura nga IVMT, në të cilat duhet të përfshihen procesverbalet e konstatimit të mbajtura nga inspektorët, vendimet e gjobave, vendimet e pezullimit, vendimet

e prishjeve dhe procesverbalet e ekzekutimit të këtyre prishjeve, kallëzimet penale, kërkesat drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv, informacioni periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT, planet vjetore dhe planet mujore të punës të miratuara nga kryeinspektori.

Titulli i gjetjes: Mos funksionim i Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit.

Situata: Në Bashkinë Pukë funksioni i kontrollit për respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryhet nga Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT).

IVMT Bashkia Pukë, sipas strukturës organizative të miratuar me VKB nr. 48 datë 19.01.2022, ka në strukturë 2 punonjës, Kryeinspektor (1) dhe Inspektor (1).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, lidhur me strukturën dhe funksionimin e IVMT Pukë, u konstatua si më poshtë vijon:

-Për vitin 2022, IVMT nuk ka funksionuar si strukturë, pasi nuk ka asnjë punonjës të punësuar dhe për rrjedhojë nuk është kryer kontroll për respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

-Veç sa më sipër, numri i punonjësve të IVMT, pra 2 punonjës, të përcaktuar në strukturën e miratuar me urdhër nr. 48 datë 19.01.2022, nuk siguron zbatimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 1 të nenit 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar:

*“Për ushtrimin e përgjegjësi dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore **kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë**, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.*

-Pra veç kryeinspektorit, duhen 2 inspektor, që të sigurohet respektimi i detyrimit ligjor të mësipërm.

-Gjithashtu nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Pukë, si dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit¹⁷, konstatohet se për vitin 2022 nuk është bërë shpallje për 2 pozicione të lira pune, kryeinspektor dhe inspektor, sipas strukturës së miratuar (1) Kryeinspektor dhe (1) Inspektor, ç’ka do të thotë se nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës.

Kriteri: Pika 1 në nenin 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar: Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

Ndikimi: Mungon institucioni përgjegjës për kontrollin e zhvillimit të territorit nga ndërtimet e pajisur me leje ndërtimi, si dhe nga ndërtimet e kundërligjshme.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës, në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe plotësimin e organikës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për krijimin e pozicionit të punës edhe për 1 inspektor më tepër.

-Gjithashtu të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e zhvillimit të territorit.

III.2.7. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

2.7.1.Trajtimi i kërkesës me nr. 1310 prot., datë 01.12.2022, F.Sh.F.

Në zbatim të pikës 7 të Programit të Auditimit “Të ndryshme të dala gjatë auditimit” u konsiderua si e nevojshme zhvillimi, në ambientet e Bashkia Pukë, i një verifikimi nga audituesit e KLSH-së, në prezencë të përfaqësuesve të subjektit të auditimit z. E. K, me

¹⁷ <https://ëëë.puna.gov.al/kerko>

detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike.

Objekti i këtij akt verifikimi është kërkesa me nr. 1302/1 prot., datë 05.06.2023 e paraqitur nga z. I. Sh, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit, administruar pranë Kontrolli të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 531/3 prot., datë 07.06.2023, konkretisht si më poshtë vijon.

Nga grupi i auditimit i cili po kryen veprimtarinë audituese në Bashkia Pukë sipas programit të auditimit me nr. 867/1 prot., datë 10.10.2023, u kërkuar dokumentacion në lidhje me zbatueshmëria e ligjit nr. 79/2017 datë 27.04.2017 “Për sportin”, i ndryshuar me ligjin nr. 105/2020 datë 29.07.2020 “Për sportin, nga ku u vendos në dispozicion dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Shkresa e dërguar nga Bashkia Pukë, Sektori Prokurimeve Publike dhe Juridik, me lëndë “Kthim përgjigje për kërkesën tuaj për fillimin e procedurave për shitjen e aksioneve tek “F. K Tërbuni”, drejtuar Federatës Shqiptare të Futbollit, në të cilën citohet se: “Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” në ligjin nr. 79/2017 datë 13.09.2023 “Për sportin” i ndryshuar me ligjin nr. 105/2020 datë 29.07.2020 dhe sipas të dhënave të rregjistrimit tregtar të shoqërisë “F. K Tërbuni”, ku rezulton se Bashkia Pukë është zotëruese e 100 % të aksioneve. Ju informojmë se Bashkia Pukë nuk ka pasur asnjë kërkesë apo interesim për shitjen e aksioneve që ka tek “F. K. Tërbuni” sh.a. Thjeksojmë se Bashkia Pukë është i gatshëm të zhvillojë procedurat ligjore përkatëse në momentin e parë që shitja e aksioneve do miratohet në Këshillin Bashkiak (pas Konstituimit të Këshillit të ri) dhe do të caktohet eksperti përkatës për nxjerrjen e vlerës së plotë të “F. K Tërbuni” sh.a.

2. Dokumentacioni i regjistrave kontabël të aktiveve të Bashkia Pukë, për vlerën dhe përcaktimin e aksioneve të shoqërisë “F. K Tërbuni”, në të cilën Bashkia është zotëruese në masën 100 % të aksioneve.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:

Referuar shkresës së sipërcituar, drejtuar FSHF-së, bazuar në pasqyrat financiare të Bashkia Pukë, rezulton se kjo Bashki ka ende në zotërim aksione të shoqërisë “F. K Tërbuni” prej 100% .

Pra konstatohet se nuk është marrë asnjë iniciativë lidhur me përcaktimet ligjore për nxjerrjen në shitje të aksioneve të shoqërisë tregëtare sportive e konkretisht me nenin 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 “Për sportin”, në të cilin citohet se:

1. *Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregëtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.*
2. *Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregëtare sportive.*
3. *Nëse në përfundim të periudhës një vjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregëtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.*

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm dhe Sektori Juridik të marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve që zotëron në F. K. Tërbuni. Në rast se nuk realizohet procesi i shitjes, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubi i mësipërm duhet të krijohet nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore.

2.7.2. Mbi shqyrtimin e ankesës së z. P. N. T.

Me anë të shkresës pa numër protokollit, me datë 29.05.2023, dhe administruar në KLSH, me nr. 490 prot., datë 29.05.2023, z. P. N. T, parashtron problematikën e tij në lidhje me pretendimin se Ish Kryetari i Komunës Luf-Qerret, z. Rr. D, për mospagesën në Komunë ndaj nipit të ankuesit, i cili është me “Statusin e Jetimit”.

Në bazë të dokumentacionit të bashkëngjitur ankesës janë paraqitur shkresat/vendimet e mëposhtme:

1. Shkresa me nr. P-235/1 prot., datë 06.10.016, në të cilën pasqyrohet kthimi i përgjigjes nga Ministria e Drejtësisë, drejtuar z. P. T për shqyrtimin e ankesës nga Drejtoria e Inspektimit

Gjyqësor dhe Prokurorisë, ku është shprehur se ankesa e dërguar nga ankuesi është jashtë kuadrit ligjor të kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë dhe i ka sugjeruar për zgjidhjen e problemit ti drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.

2. Ankuesi parashtron se këtë problematikë e ka ndjekur edhe në rrugë gjyqësore e cila me Vendimin nr. 52-2016-10 datë 19.01.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka pushuar gjykimin e çështjes civile.

3. Shkresa me nr. P-235/1 prot., datë 06.10.2016, në të cilën pasqyrohet kthimi i përgjigjes nga Ministria e Drejtësisë, drejtuar z. P. T për shqyrtimin e ankesës nga Drejtoria e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, ku është shprehur se ankesa e dërguar nga ankuesi është jashtë kuadrit ligjor të kompetencave të Ministrisë së Drejtësisë dhe i ka sugjeruar ankuesit që për zgjidhjen e problemit ti drejtohet Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë.

4. Shkresa me nr. 700/1 prot., datë 20.04.2023, z. P. N. T i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për parregullësi të Gjyqtarëve e cila ka marrë vendimin për pushimin e çështjes në fjalë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar çështjen në fjalë ku ka rezultuar se nuk ka gjetur parregullësi të vendimit të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

5. Shkresa me nr. 1167/1 datë 19.07.2023, në të cilën pasqyrohet kthimi i përgjigjes nga Bashkia Pukë, protokolluar në K.L.Sh me nr. 490/1, datë 21.07.2023.

Në përgjigje të shkresës mbi ankesën e shtetasit P. N. T, citohet se *“Pasi morëm informacion nga Njësia Administrative Qerret z. Xh. Gj. T është trajtuar me pagesë 3,000 lekë/muaj si person me statusin e jetimit nga ish Komuna Luf në Tetor të vitit 2011 konform ligjit deri në Prill të vitit 2015, ku personi nuk është paraqitur për deklarinimin 3-mujor. Për sa i përket pretendimeve të z. P. N. T për përfitime monetare për kujdestarin ligjor që ishte gjyshi i tij z. N. T sipas VKM nr.149 datë 13.03.2018 ky nuk ka qënë pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike”*.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga z. P. N. T, si dhe nga Bashkia Pukë, konstatohet se:

Z. Xh. T për periudhën 01.10.2011-31.04.2015 ka pasur statusin e jetimit, dhe kujdestar ka qënë gjyshi i tij z. N.T. Nga ish Komuna Luf-Qerret për periudhën e mësipërme z. Xh. T është trajtuar me ndihmë ekonomike në vlerën 3,000 lekë në muaj.

Trajtimi financiar i personave që kanë përfituar statusin e jetimit, për periudhën 01.10.2011-31.04.2015 përcaktohet në VKM nr.89, datë 26.01.2012 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë” dhe më konkretisht në Kreun IV, si më poshtë vijon:

Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet e ushqimit të një fëmije në kujdestari, është 9,000 (nëntë mijë) lekë në muaj”.

Masa e financimit për familjen kujdestare, për çdo fëmije të vendosur në kujdestari, është, për:

a) veshmbathjen, 10,000 (dhjetë mijë) lekë në vit;

b) shpenzime të tjera indirekte, 10,000 (dhjetë mijë) lekë në vit;

c) shpenzime për shkollën, 5,000 (pesë mijë) lekë në vit.

Pra rezulton se familja kujdestare e personit Xh. T, nuk ka përfituar plotësisht masën e financimit dhe ankesa e personit P. T për likuidimin e diferencës qëndron.

Sa më sipër, sipas përlllogaritjeve kemi:

Vlera e llogaritur për 1 vit është, 12 muaj*9,000 lekë

10,000/ vit

10,000/ vit

5,000/ vit

=108,000 + 25,000 = 133,000

Për vitin 2011, vlera e përlllogaritur është 3*9,000 = 27,000 lekë + 25,000/12*3= 6,250, pra në total 33,250 lekë;

Për vitin 2012, vlera e përlllogaritur është 133,000 lekë;

Për vitin 2013, vlera e përlllogaritur është 133,000 lekë;
Për vitin 2014, vlera e përlllogaritur është 133,000 lekë;
Për vitin 2015, vlera e përlllogaritur është $4 \times 9,000 = 36,000$ lekë + $25,000/12 \times 4 = 44,333$ lekë.
Shuma e përfituar nga z. Xh. T për periudhën e sipërcituar është në vlerën $55 \times 3,000 = 165,000$ lekë.

-Pra në total Bashkia Pukë i detyrohet z. Xh. T dhe Kujdestarit të tij në vlerën 311,550 lekë.
Pavarësisht faktit se personi nuk është paraqitur pranë ish Komunës Luf-Qëndër apo Bashkisë Pukë për të marrë përfitimin e fituar nga statusi i jetimit, sipas pretendimit të Bashkisë Pukë (Nuk ka detyrim të paraqitet, nëse nuk do që ti tërheqi leket, nuk ka asnjë referencë ligjore që i shuan këto detyrime, nëse personi nuk paraqitet për një afat të caktuar), përsëri duhet të njihet si detyrim sepse ja njeh ligji të drejtën për të përfituar dhe ky detyrim duhet të ishte kontabilizuar në pasqyrat financiare të Bashkisë Pukë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithëm të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës debitoare 311,550 lekë, gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimit të mësipërm.

-Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, rezulton se personi P. N. T nuk ka bërë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, me qëllim kërkimin e masës financiare sipas VKM nr.89, datë 26.01.2012.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIMET:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Në Bashkinë Pukë nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

-Në Bashkinë Pukë, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 17-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit

dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktivitetin e Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Pukë për periudhën objekt auditimi, nga data 01.01.2022 – 31.12.2022, rezulton se: Megjithëse është krijuar si strukturë Njësia e Auditit të Brendshëm me vendim nr. 48, datë 19.01.2022, ajo nuk ka funksionuar për asnjë ditë pasi nuk është plotësuar me punonjës, veprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

2.2.Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Pukë, në koordinim me Drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mndësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëjës nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikën e ngjashme nga bashki të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik, për blerje mallrash, shërbimesh dhe investimesh (blerje të vogla) ku u konstatua se :

-**Në 15 raste**, nuk administrohet urdhri i titullarit për caktimin e komisionit për të përlogaritur fondin limit, si dhe nuk dokumentohet përlogaritja e fondit limit;

-**Në 15 raste**, nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

-**Në 6 raste**, rezulton se OE të shpallur fitues nuk ka plotësuar kriteret e kërkuara nga AK, si dhe dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;

-**Në 15 raste**, dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

-**Në 12 raste**, afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla si dhe nuk janë përlogaritur penaltitetet;

-**Në 15 raste**, nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore; Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në nenin 26, neni 27, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 1 në nenin 79 në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 17 në Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 63-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallarave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

3.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë të marrë masa që për 12 rastet e konstatuara ku nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit/kryerja e punimeve, nga Komisioni i blerjeve të vogla të përlogariten penaltitetet përkatëse dhe të njoftohen subjektet për likuidimin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Për PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Pukë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2022-2024 dhe Buxhetin vjetor 2022 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon: *“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në këshillin e njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor”*.

-Për PBA 2022-2024 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Pukë, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, (nuk) administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Pukë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

-Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

-Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;

-Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja; Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” e nenit 5, pikën 3 të nenit 13, pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 6, pika 10, pika 33, pika 34, Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 40 në Udhëzimin nr.23, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Udhëzimi nr. 7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Pukë.

-Të dokumentohet procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;

-Të pasqyrohet trajtimi i risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat çënojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Rekomandimi: Për çdo vit buxhetor të kryhen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Pukë.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2022 paraqitet masën 87%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Pukë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur

shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022, u konstatua se janë 104 fatura të pa likuiduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën për vlerën totale 38,492,096 lekë.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likujdohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky detyrim në 30 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8, 106 dhe 107 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 27-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun e likuidimit të plotë të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit.

Përgjatë vitit buxhetor 2024 dhe në vijim

6.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 3 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 63-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Pukë, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me

aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Në procedurat e prokurimit për vitin 2024 dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 2 raste, OE është shpallur fitues në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 63-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorit ekonomik, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontabilitetit nuk është organizuar dhe nuk funksionon me program financiar elektronik siç është ai i Alpha Web etj. Të gjitha regjistrimet kontabël janë bërë në ditarët përkatës të bankës, arkës, magazinës, veprimeve të ndryshme, i pasqyrave financiare dhe bilancit përmbyllës, mbahet në mënyrë manuale në formatin hard-copy. Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe në UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”; nenit 3 dhe 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë të mundësoj blerjen dhe vënien në funksion të një programi financiar elektronik që të gjitha veprimet kontabël, transaksionet financiare dhe pasqyrat financiare të regjistrohen dhe të hartohen nëpërmjet këtij programi financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 49,517,165 lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 ka qenë në vlerën 43,436,069 lekë, me një shtesë në vlerën 6,081,096 lekë. Kjo vlerë e shtuar ka të bëjë me zbatimin e rekomandimit të lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH për regjistrimin e detyrimeve në kontabilitet të të ardhurave të planifikuara të pa mbledhura nga taksat familjare (taksa e pronës, taksës, pastrimit), tarifa e lëshimit të autorizimeve për veprimtaritë e shitjes së karburanteve, etj. Gjatë vitit 2022 këto taksa e tarifa janë arkëtuar vetëm për 1,381,307 lekë dhe për detyrimin e mbetur të pa arkëtuar në vlerën 49,517,165 lekë, Bashkia Pukë është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arkëtimin e këtyre debitorëve, në kundërshtim me Nenin 46 të ligjit Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet Administrative”, nenin 115 i Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë dhe nenit 203 i Kodit Punës në Republikën e Shqipërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë të ndjekë të gjitha rrugët administrative e gjyqësore për arkëtimin apo parashkrimin e debitorëve të ndryshëm të prapambetura nga vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.2.Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, të bashkëpunojë dhe koordinojë punën me Zyrën e Tatim-Taksave dhe me Zyrën e Gjendjes Civile dhe të marrin të dhëna nga Ujësjetës Kanalizime sh.a, Pukë apo dega e Operatorit të Shpërndarjes Elektrike (OSHE) Pukë, për të nxjerrë numrin e saktë të familjeve që jetojnë në juridiksionin e Bashkisë Pukë dhe në bazë të tyre të planifikojnë të ardhurat që do të arkëtojnë për vitet në vazhdim.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën **38,492,096 lekë**. Nga analiza, rezultoi se kjo llogari gjate këtij viti është pakësuar për vlerën 8,926,516 lekë. Një pjesë e konsiderueshme e këto detyrimet të prapambetura të pashlyera janë të trashëguara nga periudha para reformës territoriale administrative vendore të vitit 2016. Vlera e detyrimeve të pashlyera është relativisht e konsiderueshme për buxhetin e kësaj Bashkie, cila nuk është e angazhuar maksimalisht për ti planifikuar dhe likuiduar ato pjesë -pjesë deri në shuarjen e plotë të tyre. Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, për çdo vit, gjatë planifikimeve buxhetore të parashikojnë në buxhetet vjetore fonde për shlyerjen pjesore të detyrimeve të prapambetura, deri në shuarjen e plotë të tyre.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” në Bashkinë Pukë në datën 31.12.2022 përbëhet nga 5 studime e projekte në vlerën 1,137,600 lekë, nga të cilat 593,835 lekë janë projekte të trashëguara që nga ish-komunat të pa zbatuar dhe realizuar, ndërsa 543,765 lekë janë projekte të hartuara gjatë vitit ushtrimor. Paraqitja në bilanc të tyre bëhet për vlerën neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi i akumuluar. Deri në fund të vitit 2022 u vërejt se, asnjë nga këto projekte nuk është financuar dhe nuk është realizuar. Për këtë arsye bashkia nuk ka përllogaritur norma amortizimi për këto projekte, pasi sipas Standardeve të Kontabilitetit, kostot e studimit dhe projektimit përfshihen në koston e plotë të aktivitetit (investimit). Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në UMF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, në buxhetin e vitit 2024, të planifikojë fonde nga të ardhurat e veta apo të kërkojë mbështetje buxhetore pushtetit qendror për investimin dhe realizimin e këtyre projekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në datën 31.12.2022, paraqitet në vlerën 653,691,341 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, paraqitet në vlerën 584,684,266 lekë. Nga analiza e këtyre llogarive u vërejt se, në disa objekte ekzistuese në vitet e mëparshme apo në vitin ushtrimor janë kryer punime të ndryshme dhe vlera e këtyre punimeve nuk i është shtuar vlerës totale të objektit. Këto punime janë regjistruar në llogarinë analitike vetëm për vlerën e investimit të kryer pa emërtuar saktësisht objektin në të cilin është kryer punimi. Konkretisht këto investime janë kryer në: Godinën e Zhvillimit Rural dhe Turizmit, në vlerën 369,360 leke; Në vend depozitimit të mbetjeve “Fushe Qarri” në tre raste në vlerën totale 1,192,260 leke; “Blerje dhe vendosje Pllaka në Shetitoren Liqeni” me vlerë 1,151,992 lekë. Veprime këto në kundërshtim me ligjin për ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Për rastet konkrete të sipërcituara apo për çdo rast tjetër të mëparshëm

që mund të evidentohet, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bëjë regjistrimet kontabël përkatëse në librat e llogarisë duke i shtuar vlerës së objekteve ekzistuese edhe vlerat e punimeve të kryera në këto objekte.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2024

14. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2022 është në vlerën 13,842,857 lekë ose nga viti 2021 ka zvogëlim në vlerën 2,623,1765 lekë. Vlera e kësaj llogarie përfaqëson detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve për garancitë e mbajtura për ndërtimet e objekteve të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se, për disa objekte kanë përfunduar punimet, janë paraqitur situacionet përfundimtare dhe janë bërë likuidimet dhe janë kontabilizuar vlerat përkatëse të tyre, por nga Bashkia Pukë nuk janë ngritur komisionet për marrjen përfundimtare në dorëzim të objekteve, duke bllokuar kështu edhe kthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara, në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Bashkia Pukë, për çdo objekt të përfunduar dhe të kolauduar, në përfundim të periudhës së garancisë të punime, të ngrejë komisione të posaçme për marrjen në dorëzim të objekteve dhe të bëjë çlirimin e garancisë së punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuar se për vitin 2022, nuk u paraqitën problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh (aseti) në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, por në lidhje me regjistrimin e objekteve që janë në pronësi të Bashkisë Pukë, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (sektori i financës) nuk dispononte të dhëna dhe nuk kishte dokumentacion se, sa prona të kësaj bashkie janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe në çfarë faze është procesi i regjistrimit të tyre dhe sa është vlera financiare që duhet për regjistrimin e tyre. Veprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 50-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm (Zyra e Financës) të bashkëpunoi dhe koordinoj punën me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Investimeve Publike në Bashkinë Pukë për regjistrimin e objekteve të pa regjistruara në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Pukë nr. 336 date 09.12.2022 është ngritur grupi i punë për kryerjen e inventarizimit fizik të aseteve dhe materialeve, në pronësi të Bashkisë Pukë. Nga auditimi i tyre, konstatohet se, në ambientet e Bashkisë Pukë dhe në institucionet varëse të saj, ndodhen materiale të dëmtuara, amortizuara dhe jashtë përdorimi me vlerën totale 13,643,806 lekë. Këto materiale kryesisht përbehen nga tavolina, karrige, kapëse aktesh, makina llogaritëse, kompjuterë, etj. Për këto materiale jashtë përdorimit nuk është vazhduar me tej procedura konform UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me qëllim ndarjen e tyre në materiale që kanë vlerë përdorimi dhe mund të përdoren për nevoja të vetë bashkisë, në materiale mbeturinë që kanë vlerë skrapit dhe mund të shiten, etj., si dhe në mbetje të tjera mbeturinë pa vlerë përdorimi të cilat duhet të asgjësohen. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm, të marrë masa që të ngrejë komisione të posaçme për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të mbajtura në ambientet e bashkisë dhe institucionet varëse të saj.

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se:

-Në Bashkinë Pukë funksioni i kontrollit për respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryhet nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit (IVMT).

IVMT Bashkia Pukë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë me urdhër nr. 48 datë 05.01.2022, ka në strukturë 2 punonjës, Kryeinspektor (1) dhe Inspektor (1).

-Për vitin 2022, IVMT nuk ka funksionuar si strukturë, pasi nuk ka asnjë punonjës të punësuar dhe për rrjedhojë nuk është kryer kontroll për respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore dhe legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

-Veç sa më sipër, numri i punonjësve të IVMT, pra 2 punonjës, të përcaktuar në strukturën e miratuar me VKB nr. 48 datë 05.01.2022, nuk siguron zbatimin e përcaktimit ligjor të bërë në pikën 1 të nenit 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar:

-Pra veç kryeinspektorit, duhen 2 inspektor, që të sigurohet respektimi i detyrimit ligjor të mësipërm.

-Gjithashtu nga verifikimi i faqes zyrtare të Bashkisë Pukë, si dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit¹⁸, konstatohet se për vitin 2022 nuk është bërë shpallje për 2 pozicione të lira pune, kryeinspektor dhe inspektor, sipas strukturës së miratuar (1) Kryeinspektor dhe (1) Inspektor, ç’ka do të thotë se nuk janë marrë masa për plotësimin e kësaj strukture dhe ushtrimin e funksionit të inspektimit në përputhje me përcaktimet në kuadrin rregullator të fushës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 në nenin 12 në Ligjin Nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar: Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 91-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për krijimin e pozicionit të punës edhe për 1 inspektor më tepër.

-Gjithashtu të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e zhvillimit të territorit.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024

18.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kërkeses së FSHF administruar në KLSH me shkresën nr. 531/3 datë 07.06.2023, u konstatua se dokumentacioni i regjistrave kontabël të aktiveve në Bashkinë Pukë, për vlerën dhe përcaktimin e aksioneve të shoqërisë “Futbolli Klub Tërbuni”, Bashkia Pukë është zotëruese në masën 100 % të aksioneve. Pra konstatohet se nuk është marrë asnjë iniciativë lidhur me përcaktimet ligjore për nxjerrjen në shitje të aksioneve të shoqërisë tregëtare sportive veprime të cilat bien në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 105/2020, datë 29.07.2020 “Për sportin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm dhe Sektori Juridik të marrë masat e nevojshme për shitjen e aksioneve që zotëron në Futboll Klub Tërbuni. Në rast se nuk realizohet procesi i shitjes, atëherë me Vendim të Këshillit Bashkiak, klubi i mësipërm duhet të krijohet nga e para, në formën e një shoqate sportive amatore.

19.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga z.

¹⁸ <https://www.puna.gov.al/kerko>

P. N. T, si dhe nga Bashkia Pukë, konstatohet se:

Z. Xh. T për periudhën 01.10.2011-31.04.2015 ka pasur statusin e jetimit, dhe kujdestar ka qënë gjyshi i tij z. N. T. Nga ish Komuna Luf-Qerret për periudhën e mësipërme z. Xh. T është trajtuar me ndihmë ekonomike në vlerën 3,000 lekë në muaj.

Trajtimi financiar i personave që kanë përfituar statusin e jetimit, për periudhën 01.10.2011-31.04.2015 përcaktohet në VKM nr.89, datë 26.01.2012 “Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë” dhe më konkretisht në Kreun IV.

Pra rezulton se familja kujdestare e personit Xh. T, nuk ka përfituar plotësisht masën e financimit dhe ankesa e personit P. T për likuidimin e diferencës e cila qëndron.

Sa më sipër, sipas përllogaritjeve të kryera nga grupi i auditimit, Bashkia Pukë i detyrohet z. Xh. T dhe Kujdestarit të tij vlerën 311,550 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 92-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe Drejtorja e Administrimit të Përgjithëm të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e vlerës debitore 311,550 lekë, gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimit të mësipërm.

Brenda datës 30.03.2024

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga **Kryetari i Bashkisë** të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, shpërblymi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Pukë në vlerën **1,655,604 lekë**, si më poshtë:

